

AFATE DHE KUSHTE TË PËRGJITHSHME TË KONTRATËS SË QIRASË OPERACIONALE

Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme (me poshtë referuar "AKP") janë pjesë përbërëse e kontratës së qirasë së lidhur midis Porsche Leasing SHPK, në cilësinë e Qiradhënësit dhe Qiramarrësit. Termat e përcaktuar në AKP kanë të njëjtin kuptim me termat e referuar në kontratën e qirasë përveç nëse është përcaktuar ndryshe me kontratë të veçantë. Kontrata e qirasë, AKP, procesverbal për dorëzimin e objektit të qirasë, lista e çmimeve për shërbimet, policia për sigurim të detyrueshëm kundrejt përgjegjësisë për palët e treta dhe sigurimi kasko si dhe të gjitha ndryshimet dhe shtesat e mëtejshme të kontratës do të jenë të vlefshme, vetëm nëse janë kryer me shkrim dhe nënshkruar nga palët, përveç nëse është parashikuar ndryshe në AKP dhe në Kontratën e Qirasë.

PËRKUFIZIME

Kontrata e Qirasë - do të thotë kontrata e lidhur midis Qiradhënësit dhe Qiramarrësit e nënshkruar në përputhje me nenet 801 825 të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, (me poshtë referuar "Kodi Civil"), të cilët rregullojnë veprimtarinë e qirasë, dhe AKP, në bazë të të cilëve, Qiradhënësi është i detyruar të dorëzojë tek Qiramarrësi për përdorim të vazhdueshëm një send ose disa sende të caktuara të cilët mund të përdoren rregullisht brenda një periudhe të caktuar, dhe për të cilët Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit një shpërblim të rënë dakort nga palët (shuma e qirasë) si dhe t'i kthejë Qiradhënësit objektin e marrë me qira në përfundim të afatit të kontratës së qirasë të nënshkruar nga palët. Kontrata e qirasë e lidhur midis Qiradhënësit dhe Qiramarrësit nuk do të përfshijë apo nënkuptojë në asnjë rast transferimin e titullit të pronësisë së objektit të dhënë me qira nga Qiradhënësi tek Qiramarrësi. Qiradhënësi do të jetë pronari i vetëm i objektit të dhënë me qira.

Qiradhënësi - nënkupton Porsche Leasing SHPK, NUIS L31623006N, e cila është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar dhe që ekziston sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, e regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në Shqipëri, me seli të ndodhur në adresën: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 7, Rruga Monun, Tiranë Shqipëri. Qiradhënësi do të ketë të drejtën e pronësisë së objektit të qirasë dhe i jep me qira Qiramarrësit objektin e qirasë përgjatë gjithë afatit dhe kohëzgjatjes së Kontratës së qirasë.

Qiramarrësi - nënkupton individin ose personin juridik, i cili është përdorues i sendit objekt i Kontratës së Qirasë, referuar si Qiramarrësi, që ka nënshkruar Kontratën e Qirasë me Porsche Leasing SHPK, në cilësinë e Qiradhënësit, të cilit Qiradhënësi, i ka dhënë të drejtën të përdorë dhe mbajë sendin objekt i Kontratës së Qirasë, për një periudhe të caktuar, kundrejt pagesës së shumave të qirasë të rënë dakord, sipas planit të caktuar të pagesave.

Objekti i Qirasë - nënkupton çdo objekt të luajtshëm i përcaktuar individualisht, pajisje ose pjesë/makineri, të cilat Qiradhënësi, në cilësinë e pronarit, ia dorëzon Qiramarrësit për përdorim sipas Kontratës së qirasë.

Vlera e mbetur e Objektit të qirasë - nënkupton vlerën e përcaktuar të sendit Objekt i Qirasë, në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë, e cila bazohet në veprimet e Qiramarrësit, nëse ky i fundit ka vepruar në përputhje me dispozitat e Kontratës së Qirasë, për ta përdorur Objektin e Qirasë në përputhje me qëllimin e tij, duke respektuar kilometrazhin e rënë dakord, kryerjen e shërbimit të rregullt në servis, si dhe kthimit të Objektit të Qirasë, pa demtime, në përfundim të afatit për të cilën është nënshkruar Kontrata e Qirasë.

Depozita e Garancisë - nënkupton shumën monetare e cila paguhet nga Qiramarrësi tek Qiradhënësi, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe të AKP, por në çdo rast përpara dorëzimit të objektit të qirasë, e cila mbahet nga Qiradhënësi deri në përfundim të afatit të kontratës së qirasë dhe shlyerjes së të gjitha detyrimeve nga ana e Qiramarrësit. Depozita e Garancisë nuk mund të përdoret përveçse në rast të zgjidhjes së Kontratës së qirasë përpara afatit të përcaktuar në të, dhe në këtë rast Qiradhënësi është i autorizuar të mbajë shumën e garancisë derisa të gjitha detyrimet e Qiramarrësit që rrjedhin nga Kontrata e qirasë dhe këto AKP për qiranë, përfshirë këtu detyrimin për kompensimin e dëmeve të shlyhen plotësisht.

1. KONTRATA E QIRASË / PRONËSIA / NDALIMI I TRANSFERIMIT TË TË DEJTAVE TË PËRFUARA ME AUTORIZIM

1.1. Të drejtat dhe detyrimet e Qiradhënësit dhe Qiramarrësit rregullohen me Kontratën e Qirasë. Kontrata e Qirasë, lidhet për një periudhë të caktuar kohore, ku specifikohet Objekti i Qirasë, numri i përgjithshëm i pagesave dhe shumat për tu paguar, vlera e mbetur e sendit Objekt i Qirasë në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë, mjetet monetare për sigurimin e pagesës së detyrimeve, si dhe kushtet e tjera në përputhje me Kontratën e Qirasë.

1.2. Palët në Kontratën e Qirasë, konstatojnë dhe janë dakord që Qiradhënësi është pronari i vetëm dhe ekzkluziv i sendit Objekt i Qirasë, si gjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, ashtu edhe pas përfundimit apo ndërprerjes së saj, ndërkohë që Qiramarrësi, nuk fiton dhe/ose nuk mund të fitojë të drejta pronësie, të sendit Objekt i Qirasë, por vetëm të drejtën e përdorimit, në përputhje me destinacionin e përcaktuar, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, duke shlyer detyrimet e rena dakort.

1.3. Gjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, Qiramarrësi nuk mund të ushtrojë të drejtën e pronësisë, e cila i takon Qiradhënësit, apo ndonjë të drejtë tjetër reale mbi Objektin e qirasë, dhe Qiramarrësi gëzon vetëm të drejtën e përdorimit të Objektit të Qirasë për një periudhë të caktuar kunddrejt një kompensimi të përcaktuar në Kontratën e Qirasë. Qiramarrësi nuk mundet të tjetërsojë, të vendosë barrë siguruese apo japë me nënqira Objektin e Qirasë.

1.4. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të transferojë të drejtën e përdorimit të Objektit të Qirasë tek palë të treta, për asnjë lloj shkaku ligjor ose bashkëpunim të mundshëm tregtar; Qiramarrësi nuk ka të drejtë të dorëzojë Objektin e Qirasë tek palë të treta të cilët nuk janë të kualifikuar për ta përdorur Objektin e Qirasë si dhe tek persona të cilët nuk kanë marrë miratimin paraprak me shkrim të Qiradhënësit. Dispozita e mësipërme nuk zbatohet për punonjësit e Qiramarrësit, i cili është një subjekt tregtar.

1.5. Me nënshkrimin e këtyre AKP-ve, Qiramarrësi garanton Qiradhënësin që Objekti i Qirasë nuk do të përdoret për ushtrimin e aktivitetit të qiradhënies së automjeteve (*Rent a car*), dhënie me nënqira, apo çfarëdo lloj aktiviteti biznesi nëpërmjet së cilës Objekti i Qirasë i besohet palëve të treta për shfrytëzim, përveç rasteve kur ky aktivitet është përcaktuar shprehimisht në Kontratën e Qirasë. Qiramarrësi pa pasur një marrëveshje/autorizim në formë të shkruar që lidhet me Objektin e Qirasë, nuk do të nënshkruajë marrëveshje bashkëpunimi tregtar, *franchising*, apo ndonjë marrëveshje të ngjashme mbi bazën e të cilit pala e tretë mund të ushtroje ndonjë të drejtë apo u jepet mundësia për të përdorur në mënyrë të menjëherëshme Objektin e Qirasë pavarësisht nëse personit të tretë i është transferuar në mënyrë faktike ose mbi bazen e një kontrate një e drejtë e tillë.

1.6. Qiramarrësi angazhohet që Objektin e Qirasë do ta regjistrojë veçmas nga pasuria e tij në librat kontabël dhe ta shënojë atë si pronë të Qiradhënësit.

1.7. Qiramarrësi do të informojë Qiradhënësin, për çdo fakt apo veprim të ushtruar nga palët e treta lidhur me Objektin e Qirasë, ose lidhur me ekzistencën e ndonjë propozimi për ekzekutim e pasurisë së luajtshme të Qiradhënësit, të iniciuar prej kujtdo pale të tretë. Qiramarrësi është i autorizuar dhe i detyruar të ndërmarrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme për të mbrojtur të drejtat pronësore të Qiradhënësit, madje edhe në rastet kur për këtë i duhet të përballojë shpenzime të caktuara.

1.8. Qiramarrësi angazhohet që në rast fillimi të procedurave të falimentit ose marrjen e një vendimi për fillimin e likuidimit, të informojë Qiradhënësin menjëherë, i cili në këtë rast ka të drejtë të kërkojë kthimin e Objektit të Qirasë pa vonesë dhe te mos

ngarkohet me përgjegjësi për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë. Nëse Qiramarrësi gjatë afatit të dhënë nuk kryen kthimin e Objektit të Qirasë, Qiradhënësi mund të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme, me qëllim që të rifitojë menjëherë të drejtën e zotërimit ndaj Objektit të Qirasë. Qiramarrësi gjithashtu angazhohet që të informojë pa vonesë, në formë shkresore, administratorin e Qiradhënësit lidhur me procedurat e falimentit/likuidimit.

1.9. Qiradhënësi është i autorizuar që, të ushtrojë të drejtën e tij të pronësisë mbi Objektin e Qirasë. Nëse me rregulloret e miratuara pas hyrjes në fuqi të Kontratës së Qirasë, përcaktohet ndonjë metodë detyruese e shënimit të objektit të dhënë me qira, Qiramarrësi është i detyruar ti lejojë Qiradhënësit kryerjen e një shënimi të tillë mbi Objektin e qirasë dhe kostot në këtë rast do të mbarten nga Qiradhënësi. Palët në Kontratën e Qirasë bien dakord që Qiradhënësi, për të mbrojtur të drejtën e tij pronësore është i autorizuar që të instalojë pajisje elektronike në Objektin e Qirasë që mundëson vendosjen dhe përdorimin e GPRS elektronike të Objektit të dhënë me Qira, për monitorimin e vendndodhjes. Qiradhënësi mund të përdorë GPRS elektronike, vetëm me synim monitorimin e vendndodhjes të automjetit për rastet e vjedhjes dhe Qiradhënësi nuk mund ta përdorë këtë informacion, në një mënyrë që do të cënonte privatësinë e Qiramarrësit.

1.10. Shkelja e cilësdo prej pikave të Nenit 1 të AKP, i jep Qiradhënësit të drejtën për zgjidhjen e njëanshme të Kontratës së Qirasë, duke ndjekur të gjitha pasojat juridike të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, e cila është shkaktuar nga faji i Qiramarrësit dhe është i autorizuar që:

a) para përfundimit të afatit të Kontratës së Qirasë të njoftojë Qiramarrësin që Kontrata e Qirasë është zgjidhur në mënyrë të njëanshme dhe të kërkojë kthimin e Objektit të Kontratës, pra nëse Qiramarrësi vepron vullnetarisht, personalisht ose personi te autorizuar prej tij, Qiradhënësi do të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe faktike për kthimin e Objektit të Qirasë, si dhe ti ngarkojë Qiramarrësit të gjithë shumën shpenzimeve të kryera nga Qiradhënësi lidhur me dëmin e shkaktuar.

b) të përdorë dhe ndërmarrë të gjitha instrumentet dhe mjetet e nevojshme ligjore për sigurimin e pagesave nga Qiramarrësi për të gjithë shumën e papaguar, dhe bazuar në planin e pagesës, qiratë e papaguara të cilat konsiderohen të maturuara në datën e zgjidhjes së Kontratës së Qirasë.

2. DORËZIMI I OBJEKTIT TË QIRASË/GARANCITË LIDHUR ME TË METAT E OBJEKTIT TË QIRASË

2.1. Qiramarrësi angazhohet të marrë në dorëzim Objektin e Qirasë nga Qiradhënësi në vendin dhe kohën mbi të cilën është rënë dakord midis Qiramarrësit dhe Qiradhënësit. Të gjitha shpenzimet për transportin dhe sigurinë e Objektit të Qirasë të lindura pas marrjes së njoftimit nga Qiramarrësi për marrjen në dorëzim të Objektit të Qirasë do ti ngarkohen Qiramarrësit. Nëse pas marrjes së njoftimit nga Qiramarrësi për marrjen në dorëzim të Objektit të Qirasë, Qiramarrësi refuzon ose zgjidh në mënyrë të njëanshme Kontratën e Qirasë, Qiramarrësi do të jetë i detyruar ti paguajë Qiradhënësit Shumën e Qirasë për 6 (gjashtë) muaj.

2.2. Në momentin e dorëzimit të Objektit të Qirasë, Qiramarrësi dhe Qiradhënësi do të hartojnë një procesverbal për dorëzimin e Objektit të Qirasë nga njëra palë tek tjetra. Palët bien dakord se pas nënshkrimit të procesverbalit për dorëzimin e objektit të qirasë nga Qiradhënësi tek Qiramarrësi, përgjegjësia për mangësi/defekte të rëndësishme të Objektit të Qirasë, përfshirë këtu defektet/mangësitë e fshehura që mund të ketë Objekti i Qirasë, do t'i ngarkohen Qiramarrësit dhe Qiradhënësi nuk do të konsiderohet në asnjë rast përgjegjës për këto mangësi/defekte të objektit të qirase. Në një rast të tillë, Qiradhënësi i transferon të gjitha të drejtat

Porsche Leasing Sh.p.k.

nga lista e garancisë tek prodhuesi i Objektivit të Qirasë, ndërkohë që Qiramarrësi është i detyruar të përdorë të gjitha të drejtat dhe kërkesat e përcaktuara në listen e garancisë së objektivit të qirasë pa vonesa sa i përket dorëzimit dhe Qiradhënësi do të informohet pa vonesa lidhur me veprimet e ndërmarrja në këtë aspekt. Garancia për korrektësinë e mjetit fillon të ekzistojë që nga momenti i blerjes së mjetit dhe dorëzimit të mjetit ndërmjet Qiradhënësit dhe Furnizuesit të tij.

2.3. Qiramarrësi është i detyruar që menjëherë dhe pa vonesë, të informojë Qiradhënësin për çdo mosmarrëveshje ose pretendim të iniciuar nga një palë e tretë në lidhje me Objektivin e Qirasë, i cili pretendon të drejta ndaj Objektivit të Qirasë, natyra e së cilës është e tillë, që mund të zvogëlojë, përjashtojë ose kufizojë zotërimin e papenguar të Qiramarrësit, si dhe zotërimin e ndërmjetëm nga ana e Qiradhënësit.

Në rast të nisjes së një procedure ekzekutimi, Qiramarrësi merr përsipër të informojë përmbartuesin në detyrë për pronësinë e Qiradhënësit ndaj Objektivit të Qirasë dhe në rast se Objekti i Qirasë është inventarizuar, ai është i detyruar t'i paraqesë Qiradhënësit pa vonesë regjistrin e inventarit në të cilin Objekti i Qirasë është inventarizuar, nën kërcënimin për kompensimin e dëmit.

3. RREGJISTRIMI I OBJEKTIT TË QIRASË

3.1 Qiradhënësi para se të bëjë dorëzimin e Objektivit të Qirasë tek Qiramarrësi, do të kryejë veprimet e nevojshme për regjistrimin e Objektivit të Qirasë, ndërsa Qiramarrësi, me shpenzimet e tij do të lidhë një policë sigurimi kasko për Objektivin e Qirasë me shoqërinë e sigurimit, me pjesëmarrje në dëmtimet dhe rreziqet e siguruarat të kontraktuara të pranueshme nga Qiradhënësi, një kopje e së cilës do t'i dorëzohet Qiradhënësit përpara marrjes së dorëzimit të Objektivit të Qirasë. Të gjitha shpenzimet e kryera lidhur me regjistrimin e Objektivit të Qirasë, Qiramarrësi do t'ja paguajë Qiradhënësit nëse ky shërbim nuk është i përfshirë në Kontratë. Qiramarrësi bie dakord që Qiradhënësi nuk është i detyruar të bëjë dorëzimin e Objektivit të Qirasë para likuidimit të të gjitha shpenzimeve lidhur me regjistrimin e Objektivit të Qirasë dhe marrjes së një police sigurimi kasko të pranueshme për Objektivin e Qirasë.

3.2 Qiramarrësi merr përsipër që të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë së regjistrimit të Objektivit të Qirasë, t'i dorëzojë Qiradhënësit një dokument i cili vërteton kontrollin e kryer teknik të Objektivit të Qirasë, lejen e qarkullimit, si dhe dokumenta të tjerë të nevojshme në përputhje me këto AKP. Rregjistrimi i Objektivit të Qirasë si dhe çdo veprim tjetër të nevojshëm në këtë drejtim, do të kryhen nga Qiradhënësi, me shpenzimet e Qiramarrësit, nëpërmjet një agjencie ose shoqërie të autorizuar. Qiradhënësi nuk është i detyruar të regjistrojë Objektivin e Qirasë dhe t'i dorëzojë Qiramarrësit lejen e qarkullimit dhe dokumentet e tjera të nevojshme për përdorimin e Objektivit të Qirasë, në rast se Qiramarrësi nuk ka paguar sipas afateve kohore të parashikuara, qiratë dhe detyrimet e tjera financiare sipas Kontratës së Qirasë, detyrimet në bazë të Policës së Sigurimit Kasko të lidhur me Objektivin e Qirasë, si dhe shpenzimet e regjistrimit të Objektivit të Qirasë. Të gjitha shpenzimet lidhur me kontrollin teknik të Objektivit të Qirasë, rregjistrimin, sigurimin e detyrueshëm lidhur me përgjegjësinë ndaj palëve të treta dhe sigurimin kasko të Objektivit të Qirasë, për kohëzgjatjen e Kontratës së Qirasë, i përballon Qiramarrësi.

3.3. Qiramarrësi në momentin e dorëzimit të lejes së qarkullimit me qëllim zgjatjen e afatit të regjistrimit të Objektivit të Qirasë, do të dorëzojë Qiradhënësit edhe policën e sigurimit kasko si dhe Vërtetimin për shlyerjen e të gjitha detyrimeve, referuar marrëveshjes për sigurimin kasko. Si dokument për shlyerjen e detyrimeve referuar marrëveshjes për sigurimin kasko, do të pranohet vetëm dokumenti original i lëshuar nga shoqërisë e cila ka bërë sigurimin, ndërkohë që Qiradhënësi nuk e ka për detyrë të kryejë rregjistrimin e Objektivit të Qirasë dhe as dorëzimin e dokumenteve të nevojshme për përdorimin e Objektivit të Qirasë, përpara se Qiramarrësi të paraqesë

Vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve në bazë të kontratës për sigurimin kasko dhe policës së sigurimit kasko të lidhur me Objektivin e Qirasë, si edhe Vërtetimit për shlyerjen e të gjitha shpenzimeve të lindura lidhur me Objektivin e Qirasë.

3.4. Në qoftë se për shkak të neglizhencës/mosveprimit të Qiramarrësit, Qiradhënësi kryen pagesat lidhur me rregjistrimin e Objektivit të Qirasë, shpenzimet do t'i faturohen Qiramarrësit të cilat do ti shtohen me normën aktuale të TVSH-së. Qiramarrësi, menjëherë pas nënshkrimit të AKP, do të paguajë faturën.

3.5. Vonesa ose mosveprimi i Qiramarrësit në përmbushjen e detyrimeve të pikave të nenit 3, do të konsiderohen shkelje të rënda të detyrimeve kontraktuale dhe i jep Qiradhënësit të drejtën për të zgjidhur në mënyrë të njëanshme Kontratën e Qirasë, e cila nuk është zbatuar nga ana e Qiramarrësit. Nëse Qiramarrësi, edhe pas marrjes së njoftimit se ka pasur shkelje të detyrimeve kontraktuale, nuk e korrigjon shkeljen e përmendur, pra pas dy përpjekjeve për dorëzim në afatin prej 15 ditëve, nëse Qiramarrësi nuk e merr njoftimin për ndonjë arsye.

3.6 Të gjitha detyrimet, përfshirë taksat mbi qarkullimin lidhur me Objektivin e Qirasë dhe me shërbimet shoqëruese, për kohëzgjatjen e Kontratës së Qirasë, përballohen nga Qiramarrësi.

4. SIGURIMI

4.1 Gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, si dhe për periudhën që Objekti i Qirasë është në zotërim të Qiramarrësit, Objekti i Qirasë duhet të jetë i siguruar me kontratën dhe policën e sigurimit të ciat janë në emër të Qiradhënësit. Qiramarrësi merr përsipër që, për të gjithë kohëzgjatjen e Kontratës së Qirasë, deri në kthimin e Objektivit të Qirasë dhe shlyerjen e të gjitha detyrimeve nga Kontrata e Qirasë, në përputhje me kushtet e shoqërisë sigurouese, me shpenzimet e veta dhe në emër të Qiradhënësit do të lidhë Marrëveshjen për sigurimin e detyrueshëm të përgjegjësive ndaj palëve të treta, me sigurim shtesë të udhëtarëve, sigurim të plotë kasko, që përfshin edhe mbulimin nga vjedhja, si dhe sigurimin nga thyerja për pajisjet e punës në mjet, pra për automjetin në tërësi, si dhe që në afat do të paguajë primet e sigurimit. Sigurimi kasko i automjetit duhet të mbulojë rreziqet, aksidentet dhe dëmet e përcaktuara nga kushtet e siguruesit. Kontratat e sigurimit janë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë dhe Qiramarrësi merr përsipër t'i dorëzojë Qiradhënësit pa vonesë, një kopje të Policës së Sigurimit.

4.2. Nëse palët në Kontratën e Qirasë bien dakord kështu, Qiradhënësi për llogari të Qiramarrësit do të sigurojë vetë objektin e qiradhënies, rast në të cilin, Qiramarrësi do t'i paguajë Qiradhënësit primin e sigurimit më këste, bashkë më këstet mujore të qirasë.

4.3. Qiramarrësi nuk do ta përdorë Objektivin e qirasë në zona në të cilat shoqëria e sigurimit me të cilën është lidhur kontrata e sigurimit, nuk parashikon mbulim dhe nëse Qiradhënësi do të veproje në kundërshtim me këtë parashikim, atehere ky i fundit do të paguajë të gjithë shumën e dëmit të mundshëm që mund të shkaktohet Qiradhënësit nga një veprim i tillë.

5. PAGESAT

5.1 Qiramarrësi është i detyruar të paguajë Qiradhënësit Shumën e Qirasë për përdorimin e Objektivit të Qirasë në shumën dhe kohën e përcaktuar në Kontratën e Qirasë gjatë gjithë kohëzgjatjes dhe vlefshmërisë së Kontratës së Qirasë.

Data e faturimit të shërbimit të qiradhënies do të jetë data e fundit e punes e muajit për shërbimet e kryera në atë muaj. Të gjitha detyrimet që rezultojnë nga Kontrata e Qirasë shprehen në monedhën euro (EUR) nëse është rënë dakord për një model kontrate me klauzolë mbi kursin e këmbimit ose në monedhën lek (ALL), nëse nuk është rënë dakord për një model kontrate me klauzolë mbi kursin e këmbimit. Nëse është rënë dakord për një një model kontrate m e

Porsche Leasing Sh.p.k.

klauzolë mbi kursin e këmbimit shuma e qirasë përlogaritet me kursin e këmbimit të rënë dakord, i cili përcaktohet në Kontratën e Qirasë, dhe në klauzole.

5.2 Kësti mujor i qirasë i kontraktuar nga palët, maturohen dhe duhet të paguhet në datat dhe brenda afateve të përcaktuara në Kontratën e Qirasë. Me pagesat e pranuar, në rast vonëse, së pari shlyhen faturat me date me të vjetër dhe me pas faturat me date të mëvonshme. Nëse palët në Kontratën e Qirasë arrijnë të dakordësojnë shtyrjen e pagesës së shërbimeve, me Kontratën e Qirasë do të përcaktohet afati i shlyerjes, duke e llogaritur nga data e faturimit të shërbimeve të detyrueshme për Qiramarrësin,

5.3 Qiraja paguhet në llogarinë bankare të qiradhënësit në numrin e llogarisë bankare të njoftuar/paraqitur Qiramarrësit nga Qiradhënësi. Qiramarrësi është i detyruar të paguajë shumën e qirasë në llogarinë bankare të qiradhënësit në datën e pagimit edhe në rast se Qiramarrësi nuk ka marrë në dorëzim nga Qiradhënësi faturën perkatese të shumës së qirasë mujore të pagueshme. Data e shlyerjes së Shumës së Qirasë, konsiderohet dita kur bëhet pranimi i pagesës dhe kur Shuma e Qirasë kreditohet në llogarinë bankare të Qiradhënësit.

5.4 Qiramarrësi do të paguajë Qiradhënësit çdo shume që rrjedh nga çdo ndryshim i taksave të pagueshme nga Qiramarrësi si dhe çdo kosto tjetër sipas Kontratës së qirasë. Të gjitha rrethanat e tjera të cilat mund të kenë ndikuar mbi të drejtat dhe detyrimet e paleve dhe të cilat nuk janë shkaktuar nga Qiradhënësi (ndryshimi i ligjit të zbatueshem, masat nga çdo autoritet i kompetent, rritja e vlerës së blerjes së automjetit objekt i qirasë pas nënshkrimit të kontratës së qirasë por përpara dorëzimit të automjetit objekt i qirase etj) do të autorizojë Qiradhënësin të rregullojë shumën e qirasë për një maksimum deri në 20% të shumës së qirasë.

Gjatë këtij rregullimi, nuk është e nevojshme të përpilohet dhe të nënshkruhet një aneks i veçantë i Kontratës së Qirasë dhe Qiradhënësi do të njoftojë Qiramarrësin me shkrim për ndryshimet e sipërpërmendura. Në rast se rregullimi i shumës së qirasë do të tejkalojë 20%, palët do të nënshkruajnë një shtesë të kontratës së qirasë, përmes të ciles do të bien dakord mbi këtë ndryshim, në rast të kundërt Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratën e Qirasë në mënyrë të menjëhershme.

5.5. Nëse Shuma e Qirasë mujore është kontraktuar si e ndryshueshme/variable, caktuar në përputhje me normën 3M EURIBOR dhe në ditën e parë të tremujorit që u nënshkrua Kontrata e Qirasë, Qiradhënësi ka të drejtë që përveç korrigjimeve për sa më sipër, të korrigjojë Shumën e Qirasë dhe në rastin kur vlerat e 3M EURIBOR kanë ndryshuar krahasuar me këtë normë në momentin e nënshkrimit të Kontratës së Qirasë, përshtatjes/përditësimit të fundit të Shumës së Qirasë për më tepër se ±0,25 pikë përqindje. Përshtatja do të kryhet 4 (katër) herë në vit, çdo 03/01 (3 janar), 01/04 (1 prill), 01/07 (1 korrik) dhe 01/10 (1 tetor), Qiradhënësi do të informojë Qiramarrësin për ndryshimin e Shumës së Qirasë në formë shkresore jo më vonë se 5 ditë përpara maturimit të pagesës së Shumës së Qirasë. Ndryshimi i Shumës së Qirasë mbi këtë bazë do të bëhet pa lidhur një aneks të veçantë, por me dërgimin e njoftimit. Në rast se shuma e qirasë do të tejkalojë 20%, palët do të nënshkruajnë një shtesë të kontratës së qirasë, përmes të ciles do të bien dakord mbi këtë ndryshim, në rast të kundërt Qiradhënësi ka të drejtë të zgjidhë Kontratën e Qirasë në mënyrë të menjëhershme.

5.6. Qiramarrësi është i detyruar të paguajë rregullisht shumën e qirasë edhe në rast se Qiramarrësi për çdo lloj arsye nuk do të jetë i aftë të përdorë ose do të kufizohet të përdorë automjetin objekt i qirasë dhe çdo vërejtje e mundshme nga Qiramarrësi lidhur me pagesën e shumës së qirasë mujore dhe kosto të tjera, nuk do të përbëjë një arsye për mospërbushjen e detyrimit për pagesën e shumës mujore të qirasë. Për pagesat e vonuara të shumës mujore të qirasë, Qiradhënësi do të llogaritet dhe do të ngarkojë Qiramarrësit një normë interesi prej 2% për çdo ditë duke filluar nga dita

maturimit të kështu mujor, Qiradhënësi do të llogarisë dhe do të ngarkojë Qiramarrësit interesin e rënë dakord nga Palët nënshkruese në shumën e kamatvonesës në përputhje me rregulloret në fuqi në ditën e përlogaritjes së interesave.

5.7 Të gjitha Shumat e Qirave që eventualisht parapaguhet, nuk kthehen, por llogariten si pagesa të qirave të mëvonshme për të cilat interesi nuk llogaritet në favor të Qiramarrësit.

6. MJETET E SIGURIMIT: AUTORIZIMI I POSAÇËM/GARANCIA

AUTORIZIMI I POSAÇËM

6.1 Nëse palët bien dakord, Qiramarrësi duhet të lëshojë një autorizim të posaçëm tek avokati i zgjedhur nga Qiradhënësi, i cili autorizon atë që në emër e për llogari të qiramarrësit dhe bashkë me Qiradhënësin të hartojnë nënshkruajnë dhe paraqesin një kërkesë në gjykatën kompetente me qëllim të kaktimit të një seance përmes se ciles gjykata do të pajiset me procesverbalin për marreveshjen e kerkuesit dhe që konsiderohet vendim gjykate i ekzekutueshëm. Një gje e tillë detyron Qiramarrësin të dorëzojë objektin e qirasë për shkak të mospërbushjes së detyrimeve të parashikuara nga Kontrata e qirasë si dhe të marrë pjesë në seancë gjyqësore në emër e për llogari të tij në mënyrë që të ndërmarrë të gjitha veprimet e tjera ligjore për përfundimin e asaj veprimtarie ligjore

6.2 Nëse me dispozitat e Kontratës së Qirasë, nuk është parashikuar dorëzimi i një autorizimi të posaçëm, si mjet për sigurimin e shlyerjes së rregull të detyrimeve, përjashtohet zbatimi i dispozitës 6.5 të AKP.

DEPOZITA E GARANCISË

6.3 Qiramarrësi do të paguajë Qiradhënësit, në momentin e nënshkrimit të kontratës së qirasë dhe të ketyre AKP, por gjithsesi përpara marrjes në dorëzim se Objektit të qirasë nga Qiramarrësi, një depozitë garancie pa interes për sigurimin e shlyerjes së detyrimeve të qiramarrësit e cila do të perbejë shumën e garancisë, në shumën e rene dakord midis paleve, dhe kjo shume do të mbahet nga Qiradhënësi gjatë gjithë kohëzgjatjes së Kontratës së qirasë. Në momentin e kryerjes së pagesës së shumës së Depozitës së Garancisë nga ana e Qiramarrësit, Qiradhënësi në përputhje me shkresën informuese dhe kesaj kontrate, do të kryejë pagesën e kesaj shume në favor të qiramarrësit. Fatura tatimore do të përfshijë TVSH e aplikueshme sipas Legjislacionit Shqipëtar në fuqi. Qiradhënësi, pas arkëtimit të shumës së Depozitës së Garancisë do të fillojë procedurat për blerjen e automjetit nga shitesi i autorizuar, si dhe procedurat e tjera të nevojshme për regjistrim, pajisjen me targa etj. të objektit të qirasë operacionale.

6.4 Për kohëzgjatjen e Kontratës së Qirasë, shuma e garancisë nuk mund të përdoret për përlogaritjen e Shumës së Qirasë ose shpenzimeve të tjera që i detyrohen Qiramarrësit, me përjashtim të rastit të zgjidhjes/të Kontratës së Qirasë përpara përfundimit të afatit për të cilin është lidhur, kur Qiradhënësi është i autorizuar, pa pëlqimin e Qiramarrësit, të përdorë fondet e marra në bazë të garancisë për të shlyer Shumën e Qirasë së caktuar të maturuar dhe të papaguar, me interesat dhe kostot e parapara me ligj, si dhe për shlyerjen e dëmeve për shkak të përfundimit/zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, për të cilën Qiramarrësi do të njoftohet me shkrim. I njëjti rregull do të zbatohet edhe në rastin kur, gjatë kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, Objektit të Qirasë i shkaktohet një dëmtim, i cili është i një natyre të tillë që e bën të pamundur përdorimin e mëtejshëm të Objektit të Qirasë, kur nga shuma e garancisë së pranuar, do të shlyhen uljet e vlerës së mjetit, në përlogaritjen e dëmit nga ana e shoqërisë siguruese në përputhje me kushtet e siguruesit, pjesëmarrja në dëmin në përputhje me kushtet e kontraktuar të sigurimit dhe detyrimet e maturuara e të papaguara të Qiramarrësit, duke përfshirë primin që i detyrohet policave të sigurimit. Në rast se pas shlyerjes së të gjitha detyrimeve të Qiramarrësit të kontraktuar nga ky nen, mbeten fonde monetare të papërdorura, ato do të kthehen Qiramarrësit.

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

6.5 Pas përfundimit të kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë dhe pasi Qiramarrësi ka likuaduar të gjitha detyrimet e tij për tu paguar, Qiradhënësi do t'i kthejë Qiramarrësit shumën e garancisë, pa të drejtën e përllogaritjes së interesave ndaj kësaj shume.

6.6 Nëse me dispozitat e Kontratës së Qirasë nuk është parashikuar pagesa e një Garancie, si mjet për sigurimin e shlyerjes së rregullt të detyrimeve, përjashtohet zbatimi i dispozitave nga 6.3 deri në 6.5 të AKP.

7. DORËZANËSI

7.1 Ky nen lidhur me Dorëzanesin do te jete i zbatueshem vetem ne mungese te depozitës se garancisë dhe nëse palët bien dakort. Ne mungese te Depozitës se Garancisë, Qiramarrësi është i detyruar te siguroje garanci nga një person juridik ose një individ. Dorëzanesit kanë statusin e garantuesit të paguesit, pra, janë bashkërisht dhe individualisht përgjegjës ndaj Qiradhënësit për të gjitha detyrimet e ndërmarra ose detyrimet që rrjedhin nga dhe në bazë të Kontratës së Qirasë dhe AKP, përfshi edhe detyrimin për dëmshpërblimin e dëmit eventual për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë që do të përllogaritet në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate Qiraje.

7.2 Dorëzanesit janë bashkërisht përgjegjës ndaj Qiradhënësit për të gjitha detyrimet e Qiramarrësit, sipas Kontratës së Qirasë dhe nëse palët në marrëveshje bien dakord kështu, e kanë për detyrë që për të siguruar shlyerjen e të gjitha detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë dhe AKP, të dorëzojnë një numër të caktuar të kambialeve të vetëm bosh (solo) të cilat janë regjistruar në klauzolën "pa raportim" dhe në klauzolën "pa kundërshtim" plotësuar në përputhje me legjislacionin si dhe autorizimet përkatëse për kambialet në numrin e kambialeve të lëshuara, në favor të Qiradhënësit dhe Qiradhënësi në përputhje me këtë është i autorizuar në rast të maturimit të ndonjë detyrimi nga ose në bazë të Kontratës së Qirasë të kërkojë përmbushjen ose të kryejë ekzekutimin përmbarimor ndaj gjithë pasurisë, si nga Qiramarrësi ashtu edhe nga garantuesi i përbashkët. Garantuesi i përbashkët angazhohet që, në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të Qiramarrësit referuar Kontratës së Qirasë, do të kryejë të gjitha Shumat e qirasë për Qiradhënësin, ose për personin që cakton ai.

7.3 Në rast të mospërmbushjes së detyrimeve nga Qiramarrësi, sipas Kontratës së Qirasë, Qiradhënësi do të njoftojë dorëzanesin për ekzistencën e detyrimeve të maturuara dhe të paguara të Qiramarrësit dhe e fton për t'i shlyer këto detyrime brenda një afati të caktuar 8 ditor, prej ditës së marrjes së njoftimit. Pas mbarimit të afatit të dhënë, Qiradhënësi do të veprojë në bazë të Nenit 7.20 të AKP.

7.4 Dorëzanesi duke nenshkruar deklaratën e garancisë, konfirmon se ka marrë parasysh të gjitha rrethanat, mbi bazën e të cilave ka përcaktuar aftësinë e tij për të garantuar plotësisht përmbushjen e duhur të të gjitha detyrimeve të Qiramarrësit, që rrjedhin nga Kontrata e Qirasë dhe nga AKP përfshirë edhe detyrimin për pagesën e dëmshpërblimit të dëmit eventual, arsye për të cilat ai heq dorë nga kundërshtimi i rrethanave që lindin pas dhënies së deklaratës së garancisë dhe merr përsipër që brenda 3 ditëve t'i dorëzojë Qiradhënësit mjete të reja identike sigurie, në rast të ekzekutimit të cilitdo mjet sigurimi të dhënë në formë garancie.

7.5 Nëse në dispozitat e Kontratës së Qirasë nuk është rënë dakord për dorëzanes si mjet për sigurimin e shlyerjes së rregullt të Shumës së Qirasë, përjashtohet zbatimi i dispozitave nga 7.1 deri në 7.4 të AKP.

8. VONESAT/PASOJAT LIGJORE

8.1 Qiramarrësi dhe Qiradhënësi bien dakort që përmbushja e detyrimeve në afat, përfaqëson një element thelbësor të Kontratës së Qirasë. Qiramarrësi merr përsipër që të njoftojë me shkrim Qiradhënësin për çdo pamundësi ose vonesë që mund të shfaqet për të kryer pagesën.

8.2 Qiradhënësi ushtron të drejtën të llogaritë normën ligjërish të lëjuar për të gjitha detyrimet e pagueshme dhe të pashlyera. Në rast se Qiramarrësi vonon pagesën e ndonjë detyrimi sipas Kontratës për më shumë se 15 ditë, Qiradhënësi do të nisë procedurën e paralajmërimit. Përveç kompensimit bazë për llogaritjen, Qiradhënësi do ti ngarkojë Qiramarrësit një shumë në vlerën 10 EURO (dhjetë euro) për paralajmërimin e parë, 15 EURO (pesëmbëdhjetë euro) për paralajmërimin e dytë, 20 EURO (njëzet euro) për paralajmërimin e tretë, ekuivalent në LEK sipas kursit zyrtar të Bankes së Shqipërisë, te një dite te meparshme se dita në të cilën është nxjerrë paralajmërimi .

8.3 Nëse Qiramarrësi nuk përmbush detyrimet që rrjedhin nga Kontrata pas paralajmërimit te trete te shoqeruar me poste te regjistruar, do te konsiderohet në mënyrë të pakthyeshme se rrethanat e dhena percaktojne se Qiramarrësi nuk do te përmbushë ndonjë prej detyrimeve te metejshme qe lindin nga Kontrata e qirasë në mënyrë të tillë qe palët te bien dakord se qiradhënësi është i autorizuar te:

a) zgjidhë Kontratën e Qirasë dhe të kërkojë pagesën e të gjitha qirave të maturuara të papaguara dhe shpenzimeve si dhe kthimin e Objektivit të Qirasë, pra mund te mare veprime për kthimin e Objektivit të Qirasë në zotërimin e tij.

b) aktivizojë instrumentet e dakordësuara të sigurimit të pagesave, për të gjithë shumën e të gjitha qirave të maturuara dhe të papaguara në përputhje me planin e pagesës së qirasë, pavarësisht nga data e maturimit të tyre .

8.4 Qiramarrësi do te kompensoje Qiradhënësin lidhur me të gjitha kostot e mbetura që rrjedhin nga Kontrata (shpenzimet gjyqësore, jashte gjyqësore, administrative, shpenzimet e avokatit, kostot per vertetimet dhe vleresimet e eksperteve, kostot per kthimin e objektivit të qirasë, ruajtjen e objektivit të qirasë, kostot per gjetjen e adreses se Qiramarrësit dhe kostove te tjera).

8.5 Palët bien dakord se në rast se shuma e qirasë nuk paguhet, Qiradhënësi ruan të drejtën të marrëmbapsht objektivin e qirasë sipas Kontratës. Qiradhënësi është i autorizuar dhe Qiramarrësi pranon dhe njëh në mënyrë te pakthyeshme të drejtën e Qiradhënësit per te ndermarre të gjitha veprimet per mbrojtjen e të drejtës se pronesise mbi objektivin e qirasë, përfshirë këtu të drejtat perkatese qe i perkasin Qiradhënësit te cilat rrjedhin nga Kodi Civil Shqiptar, nëse detyrimet që rrjedhin nga Kontrata nuk jane përmbushur brenda afatit ose në rast se Qiramarrësi vepron në kundërshtim me parimet e ndergjegjes dhe ndershmerise.

8.6 Në rastet kur Qiramarrësi perdor mjetet per sigurim dhe palët bien dakord se Kontrata do te qendroje ne fuqi, Qiramarrësi është i detyruar te paraqese mjete te reja te pershtatshme dhe te vlefshme për sigurimin e pagesës te cilat do te zevendesojë mjetet e perdorura për sigurimin e pagesës te pakten 3 (tre) dite nga dita e arrijtes se marreveshjes. Nëse Qiramarrësi nuk vepron si është përcaktuar dhe brenda kesaj kontrate, do te konsiderohet se marreveshja nuk është me ne fuqi.

9. MIRËBAJTJA/PËRGJEGJËSIA PËR OBJEKTIN E QIRASË

9.1 Qiramarrësi angazhohet që me shpenzimet e veta të mirëmbajë Objektivin e Qirasë (si mirëmbajtje të rregullt ashtu edhe dhe të jashtëzakonshme), për të kryer të gjitha riparimet dhe servisin e nevojshëm dhe kujdeset vazhdimisht për gjendjen funksionale dhe të sigurt për mjedisin e Objektivit të Qirasë, në përputhje me kushtet dhe udhëzimet e prodhuesit për mirëmbajtjen, funksionimin dhe

Porsche Leasing Sh.p.k.

kushtet e garancisë së Prodhuesit për Objektivin e Qirasë, Kontratën e Qirasë, AKP-në dhe të përgjigjet për të gjitha dëmet që mund të lindin për shkak të shkeljeve lidhur me detyrimet, pavarësisht faktit nëse Objektivin e Qirasë e ka drejtuar ai vetë apo personi i autorizuar prej tij, ose ndonjë person tjetër të cilit ai i mundësoi përdorimin e Objektivit të Qirasë.

9.2 Mirëmbajtja dhe riparimi i Objektivit të Qirasë, mund të kryhet ekskluzivisht vetëm në pikat e servisit të prodhuesit të Objektivit të Qirasë, ose në servise të autorizuar, të cilët janë të konfirmuar në fletë-garancinë ose në librezën e servisit, duke përdorur detyrimisht vetëm pjesë ndërrimi origjinale të Objektivit të Qirasë. Me kërkesë të Qiradhënësit, nëse është e justifikuar dhe objektivist e mundur, Qiramarrësi do të lidhë Marrëveshje për servisin e Objektivit të Qirasë.

9.3 Qiramarrësi është i detyruar që të përdorë Objektivin të Qirasë në përputhje me rregulloret, pasi në rast të shkeljes së këtyre rregulloreve, Qiramarrësi është përgjegjës për të gjitha pasojat që rrjedhin prej këtyre rregulloreve dhe në lidhje me to do të paguajë të gjitha gjokat, apo tarifën kompensuese, pranë institucioneve, autoriteteve kompetente, ndërmarrjeve publike. Qiradhënësi është i autorizuar që në të gjitha rastet kur për shkak të shkeljeve nga Qiramarrësi paguan një gjobë/taksë në shumën e një gjobe/tarife të caktuar, si dhe shumën e të gjitha shpenzimeve të procedurës, të cilat përfshijnë tarifën për përfaqësim dhe/ose mbrojtjen, tarifën dhe shpenzimet e tjera, të arkëtojnë nga Qiramarrësi, sa më sipër shtuar me interesat e parapara me ligj mbi shumën e paguar duke filluar nga dita e pagesës ose dita e dorëzimit të vendimit për gjobë dhe 500 EUR (pesëqind EUR) shtesë, për shpenzime administrative. Qiramarrësi angazhohet që të përdorë automjetin në përputhje me rregulloret që lidhen me sigurinë dhe qarkullimin rrugor dhe nëse, me vendim të autoriteteve shtetërore, automjeti sekuestrohet ose ndalohet për shkak të një shkeljeje të rëndë të ligjit (përfshirë kryerjen e një veprë penale) për shkak të fajit të Qiramarrësit ose të personit që ka përdorur automjetin e marrë me qira, Qiradhënësi ka të drejtën e dëmshpërblimit të dëmit, në shumën e qirave të maturuara të papaguara, si dhe të qirave të kontraktuara për të ardhmen, për të gjithë kohën e ndalimit të mjetit nga organet shtetërore. Në rast se pas përfundimit të periudhës gjithsej për të cilën është lidhur Kontrata e Qirasë, Objektivin e Qirasë është ende në zotërimin e autoriteteve shtetërore, Qiradhënësi është i autorizuar të arkëtojë nga Qiramarrësi shumën e rënë dakord të vlerës së mbetur të objektivit të qirasë. Të njëjtën vlerë si dëmshpërblim, Qiramarrësi është i detyruar të paguajë edhe nëse objektivin e qirasë sekuestrohet përgjithmonë nëpërmjet një procedure penale kundër përdoruesit ose një personi të tretë të cilit Qiramarrësi ia ka besuar automjetin në përdorim.

9.4 Instalimi i mjeteve shtesë për mbrojtjen mekanike në objektivin e qirasë, aparatet alarmi dhe pajisjeve të ngjashme për mbrojtjen e objektivit të qirasë, pajisjeve të gazit automobilistik, si dhe instalimi i çdo aparati apo pajisjeje shtesë në objektivin e qirasë ose konvertimi i mjetit motorik, mund të kryhet nga Qiramarrësi vetëm me pëlqimin paraprak të Qiradhënësit dhe këto mund të kryhen vetëm në serviset e autorizuar nga ana e importuesit të objektivit të qirasë, me kushtin që instalime sa më sipër nuk ndikojnë në pakësimin ose humbjen e garancisë së prodhuesit për objektivin e qiradhënies. Qiramarrësi angazhohet që t'i raportojë Qiradhënësit veprimet e kryera pa vonesë dhe t'i dorëzojë mjetet e dhura për zhblokimin e objektivit të dhënë me qira, certifikatat për korrektësinë e pajisjeve të instaluar dhe dokumentacionin tjetër mbështetës për veprimet e kryera. Nëse qiramarrësi nuk i siguron qiradhënësit mjetet për të zhblokuar objektivin e dhënë me qira siç është rënë dakord, palët në marrëveshje bien dakord që Qiradhënësi është i autorizuar që personalisht, nëpërmjet një avokati ose nëpërmjet një shoqërie të autorizuar të regjistruar për atë lloj aktiviteti, të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore dhe veprimet faktike me qëllim zhblokimin e objektivit të dhënë me qira dhe demontimin e mjeteve që i shërbejnë zhblokimit.

9.5. Pajisjet cituar në dispozitat e nenit 9.4. të Kushteve të

Përgjithshme të Punës nuk mund të inkorporohen në mënyrë të tillë që të dëmtojnë ose zvogëlojnë vlerën funksionale dhe/ose vlerën estetike të objektivit të dhënë me qira ose të bëhet pjesë përbërëse e pronës së Qiramarrësit ose të një pale të tretë dhe duhet të jetë e disponueshme në mënyrë të tillë që të mund të ndahet në çdo kohë, nga objekti i Qirase .

9.6. Qiramarrësi i cili vepron në kundërshtim me parashikimet e Nenit 9.4 të AKP është i detyruar të kompensojë të gjithë dëmin e shkaktuar ndaj Qiradhënësit dhe Qiradhënësi në mënyrë që të perfitojë shumën si rezultat i dëmeve, mund të përdorë Depozitën e Garancisë së objektivit të qirasë.

9.7. Qiramarrësi mbart detyrimin që të sigurojë se gjate gjithë kohëzgjatjes së Kontrates objekti i qirase duhet të përmbajë të gjitha pajisjet e nevojshme të përcaktuara nga legjislati dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi, të cilat duhet të jenë të rregullta dhe të provuara/vertetuara (si për shembull trekendeshi, ndihma e shpejte, seti i dritave, aparati kundër zjarrit etj.,) ose pajisje të tjera në funksion të objektivit të qirasë të përcaktuara nga legjislati dhe rregulloret e zbatueshme në fuqi. Nëse, për shkak të sasise së pakët ose pasaktësisë së pajisjeve, Qiradhënësi ose personi i autorizuar nga Qiradhënësi gjobitet, Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë të gjithë shumën.

9.8. Qiramarrësi do ta mbajë ekskluzivisht me vete dokumentacionin në lidhje me përdorimin e objektivit të dhënë me qira (leja e qarkullimit si dhe dokumente të tjera) dhe jo në objektivin e dhënë me qira (jo në automjet) Në rast të shkakimit të dëmeve (për shembull vjedhja), dhe pamundesise për të ushtruar të drejtën që rrjedh nga sigurimi për shkak të mos zotërimit të dokumentacionit në të njëjtën kohë, Qiramarrësi është plotësisht përgjegjës për dëmin dhe i detyruar të kompensojë të gjithë dëmin e shkaktuar.

9.9. Qiramarrësi është i detyruar të informojë Qiradhënësin dhe shoqërinë e sigurimit menjëherë dhe në formë të shkruar në rast të humbjes së çelësit të automjetit, të dokumentit të regjistrimit, kodi të kartës osë çelësit master.. Të gjitha shpenzimet e lindura mbi këtë bazë, Qiramarrësi e ka për detyrë t'ja kompensojë Qiradhënësit, referuar specifikimeve të dorëzuara për shpenzimet e kryera.

10. DETYRIMI PËR RAPORTIM DHE EKZAMINIMI I OBJEKTIVIT TË QIRASË

10.1. Qiramarrësi do të njoftojë pa vonesë Qiradhënësin nëpërmjet postës së regjistruar për çdo ndryshim të selisë, ose të adresës së tij të banimit të punëdhënësit të tij, si dhe për sekuestrimin ose dëmtimin e sendit të dhënë me qira.

10.2. Nëse Qiramarrësi nuk përmbush detyrimet e tij sipas nenit 10.1 me siper, çdo dorëzim tek Qiramarrësi lidhur me adresën e percaktuar në Kontratë do të konsiderohet i vlefshëm, pavarësisht nëse Qiramarrësi ka marrë ose jo në dorëzim njoftimin dhe dita e dorëzimit të tij në poste do të konsiderohet si dita e pranimit.

10.3. Qiradhënësi ose një person i caktuar prej tij është i autorizuar të ekzaminojë objektivin e dhënë me qira në çdo kohë që ai e konsideron të arsyeshme, e për këtë Qiramarrësi merr përsipër t'i sigurojë Qiradhënësit akses të papenguar. Në rast se Qiramarrësi nuk e lejon Qiradhënësin të inspektojë objektivin e qirasë, Qiradhënësi ka të drejtë që të zgjidhë në mënyrë të njëanshme Kontratën.

11. DËMI SI PASOJE E AKSIDENTIT / VJEDHJES/ ZHUKJA

11.1. Në rast të një aksidenti me makine ose dëmi, qiramarrësi do të dorëzojë objektivin e qirasë në servis të autorizuar me të afert pa vonesë dhe do të paraqesë një raport me shkrim për dëmin e shkaktuar ndaj Qiradhënësit. Qiramarrësi është i detyruar të

Porsche Leasing Sh.p.k.

ndermarre të gjitha veprimet dhe masat e nevojshme pa vonesa dhe në përputhje me kushtet e siguruesit, procedurat e parashikuara raportin, vlerësimin dhe likuidimin e dëmit.

11.2. Në rast se objekti i qirasë është plotësisht i demtuar dhe pas përcaktimit të shkakut nga siguruari, Kontrata mund të zgjidhët në ditën e maturimit të shumës së qirasë së pare vijuese, duke llogaritur nga dita në të cilën dëmi është raportuar tek Qiradhënësi. Në këtë rast Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit të gjithë shumën e qirasë në vlerën e qirasë për muajin në të cilin është shkaktuar dëmi. Në rast se objekti i qirasë është plotësisht i demtuar, Qiradhënësi ruan të drejtën të ngarkojë Qiramarrësit të gjithë shumën e qirasë sipas Kontratës së qirasë.

11.3. Në rast të vjedhjes së objektit të qirasë, Qiramarrësi është i detyruar që pa vonesë të denoncojë vjedhjen në stacionin më të afërt policor dhe për këtë të njoftojë Qiradhënësin, duke i dërguar edhe kopjen e denoncimit penal. Në këtë rast, Kontrata zgjidhët në ditën e marrjes së konfirmimit nga departamenti kompetent i policisë së automjeti nuk është gjetur brenda një afati të arsyeshëm. Në atë rast, Qiradhënësi ka të drejtë të marrë qiranë për shfrytëzimin e sendit të dhënë me qira deri në ditën e fundit të muajit kalendari në të cilin merr Vërtetimin nga stacioni policor kompetent se sendi i dhënë me qira nuk është gjetur. Në rast të vjedhjes, Qiramarrësi është i detyruar të lajmërojë ngjarjen në departamentin kompetent të policisë, dhe është i detyruar t'i dorëzojë Qiradhënësit pa vonesë një vërtetim për vjedhjen e raportuar, si dhe një vërtetim nga departamenti i policisë së automjeti është gjetur brenda një periudhe të arsyeshme kohore.

11.4. Në rast zhdukjeje të objektit të qirasë, Qiramarrësi detyrohet që menjëherë të paraqesë një kallëzim për zhdukje në stacionin më të afërt policor si dhe në prokurorinë kompetente, t'ja raportojë zhdukjen siguruarit tek i cili është kryer sigurimi kasko, dhe për këtë procedurë të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe të bëjë të gjitha njoftimet e nevojshme, shoqërisë së sigurimit në procedurën e raportimit, vlerësimit dhe likuidimit të dëmit. Në rastin e shfaqjes së rastit të zhdukjes së automjetit të siguruar, Qiramarrësi njofton menjëherë Qiradhënësin me shkrim, si dhe detyrimisht i dorëzon Vërtetimin për denoncimin e zhdukjes së objektit të qirasë, lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, fotokopje të provës së dorëzimit të kallëzimit penal në Prokurorinë Publike kompetente, konfirmimin e ngjarjes së raportuar tek shoqëria e sigurimit ku është i siguruar objekti i qirasë. Në këtë rast, Qiradhënësi ka detyrimin të paguajë qiranë deri në ditën e fundit të muajit kalendari në të cilin objekti i qirasë u zhduk, i cili përcaktohet në bazë të dokumenteve/certifikatave të paraqitura, ndërsa Kontrata e Qirasë përfundon në ditën e pagesës së shumës së plotë të përcaktuar të sigurimit në përputhje me përlogaritjet e shoqërisë së sigurimit.

11.5. Në rast se dëmi i pësuar, për çfarëdo arsye, nuk do të kompensohet nga shuma e arkëtuar prej shoqërisë së sigurimit, apo kur shoqëria e sigurimit referuar kushteve të sigurimit nuk detyrohet të paguajë sigurimin, Qiramarrësi merr përsipër që Qiradhënësit t'i paguajë dëmin gjithësej dhe ta kompensojë për të gjitha shpenzimet shtesë, pra me shpenzimet e veta ta kthejë objektin e qirasë në gjendjen e mëparshme, ndërkohë që shpenzimet e kryera me këtë rast i faturohen Qiramarrësit në një afat të arsyeshëm kohor. Shumën e dëmit do ta vlerësojë një ekspert i caktuar nga Qiradhënësi. Qiramarrësi merr përsipër të paguajë shumën e parashikuar të dëmit dhe të gjitha shpenzimet e vlerësimit të shumës së dëmit në llogarinë e Qiradhënësit brenda 7 (shtatë) ditësh nga dita e lëshimit të fakturës për këtë. Qiramarrësi shprehet dakord që për kompensimin e dëmeve mund të përdoren mjetet e sigurimit të pagesës nga Kontrata, si dhe shuma e garancisë.

11.6. Të gjitha shumat eventuale të kompensimit për dëmin material të shkaktuar në objektin e qirasë do t'i paguhet Qiradhënësit.

11.7. Qiradhënësi nuk do të japë dakodësinë për pagesën e dëmeve ndaj siguruarit me kërkesën e tij, derisa Qiramarrësi të përmbushë të

gjitha detyrimet e duhura ndaj Qiradhënësit në bazë të Kontratës. Dakodësia për pagesën e dëmeve nuk do të jepet edhe nëse automjeti është riparuar në një servis automjetesh të paautorizuar pa dijeninë dhe miratimin e Qiradhënësit.

12. KOHËZGJATJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËVESHJES

12.1. Kontrata e Qirasë lidhet për një periudhë të caktuar kohore dhe përfundon në fund të afatit për të cilin është nënshkruar në të. Meqenëse synimi i palëve kontraktuese me rastin e lidhjes së Kontratës së Qirasë është zbatimi i saj në tërë kohëzgjatjen dhe në Vëllimin e plotë të dakordësuar, palët nënshkruese bien dakord që elementi thelbësor i Kontratës së Qirasë dhe arsyeja e lidhjes së saj është përmbushja e Kontratës së Qirasë në tërësi dhe në kohëzgjatjen e plotë.

12.2. Kontrata e Qirasë, e lidhur për një periudhë të caktuar, mund të përfundojë para afatit të rënë dakord në rastet e mëposhtme:

12.2.1. Qiradhënësi mundet që me anë të një letre rekomande me njoftim marrje, të njoftojë Qiramarrësin për zgjidhjen e kontratës (njoftim për zgjidhje), në rastet e mëposhtme:

- a. nëse Qiramarrësi refuzon që në afatin e rënë dakord të marrë objektin e qirasë
- b. nëse Qiramarrësi jep ose ka dhënë informacione të pasakta lidhur me përdorimin ose me gjendjen e objektit të qirasë;
- c. nëse Qiramarrësi ose dorëzanësi jep ose ka dhënë informacione të pasakta lidhur me të ardhurat e tij, fitimet dhe pasurinë dhe/ose nëse Vërtetohet që gjendja pasurore e Qiramarrësit ndryshon dukshëm me gjendjen e konstatuar bazuar në të dhënat që ka dhënë ai vetë, saqë po të ishte në dijeni të këtyre të dhënave, Qiradhënësi nuk do të nënshkruante Kontratën e Qirasë;
- d. nëse ndonjë prej mjeteve për sigurimin e pagesës dhe/ ose garanci të parashikuara në Kontratën e Qirasë për çfarëdo arsyebëhet i pavlefshëm, dhe Qiramarrësi nuk paraqet mjete të reja, të vlefshme sigurie brenda afatit;
- e. nëse kundër Qiramarrësit nis procedura falimentimi ose likuidimi, ose nëse Qiramarrësi ka paafësi paguese për një kohë të gjatë, për ndonjë arsye duke ja bllokuar llogaritë e biznesit për një periudhë më të gjatë se 30 ditë;
- f. nëse Qiramarrësi është vonësë për përmbushjen e plote ose të pjesshme të detyrimeve të tij lidhur me kryerjen e pagesave të shumës së qirasë ose pagesave të tjera të detyrueshme dhe pavarësisht paralajmërimeve ai vazhdon të mos përmbushë detyrimin e tij brenda afatit të parashikuar dhe në përputhje me AKP;
- g. nëse Qiramarrësi shkel detyrimin e tij për të lidhur një policë sigurimi kasko gjithëpërfshirëse për objektin e dhënë me qira, një policë sigurimi të detyrueshëm për objektin e dhënë me qira për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, për të kryer regjistrimin e automjetit;
- h. nëse objekti i qirasë nuk përdoret, mirëmbahet ose i bëhen shërbimet në servis në përputhje me kushtet e Kontratës së Qirasë, AKP dhe garancisë teknike të prodhuesit;
- i. nëse Qiramarrësi që është person juridik, transferon selinë e tij jashtë vendit, ose pushon së ekzistuari si subjekt, bëhet i paafte për të ushtruar aktivitetin tregtar;
- j. nëse Qiramarrësi që është person fizik ndryshon adresën e tij, nëse vdes ose bëhet i paafte për punë, ose nëse nuk ka pasardhës;
- k. nëse Qiramarrësi nuk përdor dhe/ose mirëmban objektin e

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. Ilogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

qirasë në përputhje me Kontratën e Qirasë;

- l. në rast rreziku ose ndodhje rrethanash të jashtëzakonshme që, sipas vlerësimit të Qiradhënësit, kërcënojnë ose vonojnë përmbushjen e detyrimeve kontraktuale të Qiramarrësit ose nëse qiradhënësi vlerëson se Qiramarrësi nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij kontraktuale;
- m. nëse Qiramarrësi përfshihet në ndonjë bashkim shoqërisht, apo shkrierje, apo ndryshime statutoare në përputhje me ligjin nr 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, pa e njoftuar paraprakisht Qiradhënësin dhe nëse ai nuk vijon me lidhjen e Aneksit të Kontratës së Qirasë brenda periudhës së caktuar;
- n. nëse Qiramarrësi shkel rëndë dispozitat e Kontratës së Qirasë;
- o. nëse Qiramarrësi me veprimet e tij cenon të drejtën e pronësise apo te drejta dhe interesa te tjera të qiradhënësit mbi objektin e qirasë;
- p. per shkaqe te tjera të përcaktuara nga ligji i zbatueshem.

12.2 Të gjitha përgjegjësitë e Qiramarrësit kundrejt Qiradhënësit, të lindura nga ose në lidhje me Kontratën e qirasë, perfundojnë në ditën në të cilën objekti i qirase i kthehet Qiradhënësit, pavarësisht momentit në të cilin Qiramarrësi ka marrë në dorëzim njoftimin për zgjidhjen e Kontrates. Qiramarrësi është i detyruar të shlyejë të gjitha detyrimet e tij që rrjedhin nga Kontrata e qirasë deri në ditën e kthimit të objektit të qirasë, pavarësisht datës në të cilën është marrë njoftimi për zgjidhjen.

12.3. Në rast të zgjidhjes së Kontratës së Qirasë Kontratës së Qirasë, Qiradhënësi ka të drejtë të arkëtojë nga Qiramarrësi të gjitha detyrimet e maturuara të papaguara bazuar në dhe në lidhje me Kontratën së Qirasë, së bashku me të gjitha dëmet që do të përlllogariten në përputhje me dispozitat e Kontratës së Qirasë. Prandaj, Qiradhënësi është i autorizuar të llogarisë dhe të mbledhë në një shumë të përgjithshme të gjithë qiranë e papaguar sipas planit të pagesës së qirasë, si dhe të gjitha kërkesat e papaguara (gjyqësore, administrative, tarifat e avokatit, shërbimi, mirëmbajtja, ruajtja, kthimi i sendeve të dhëna me qira, transporti, etj.), si dhe të përdorë të gjitha fondet e sigurisë të marra sipas Kontratës së Qirasë, duke përfshirë edhe garancinë e marrë.

12.4. Qiradhënësi pas dërgimit të njoftimit për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë, është i autorizuar të iniciojë procedurat ligjore për kthimin e objektit të qirasë, nëse Qiramarrësi nuk e kthen vetë objektin e qirasë, e në këtë kontekst mund të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme juridike dhe faktike.

12.5. Në rast të sekuestrimit të objektit të qirasë, si dhe në rastin e zgjidhjes së Kontratës së Qirasë, Qiramarrësi merr përsipër t'i sigurojë Qiradhënësit ose personit të caktuar prej tij akses të lirë në vendin ku ndodhet objekti i qirasë, dhe jo të ndërhyjë në procedurën e kthimit të objektit të qirasë dhe në lidhje me këtë heq dorë nga çdo pretendim për dëmshpërbim mbi atë ose ndonjë bazë tjetër.

13. PASOJAT LIGJORE PËR SHKAK TË PËRFUNDIMIT TË KONTRATËS SË QIRASË

13.1. Në rastin e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, Qiramarrësi angazhohet që Qiradhënësit t'ja kompensojë të gjithë dëmin që ai pëson për shkak të zgjidhjes së Kontratës së Qirasë.

13.2. Qiramarrësi, ndër të tjera, është veçanërisht i detyruar t'i paguajë Qiradhënësit, në kompensim dëmi, shumat e vlerave të dëmeve që përlllogariten në përputhje me përcaktimet e Kontratës së Qirasë, me emërtimin "Detyrime në rast të zgjidhjes së parakohshme të kontratës, kompensim dëmsh për shkak të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë". Qiramarrësi me nënshkrimin e tij konfirmon shprehimisht se para lidhjes së Kontratës së Qirasë i

janë paraqitur të gjitha pasojat sa i përket zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, si dhe se para lidhjes së Kontratës së Qirasë ka marrë parasysh të gjitha rrethanat në bazë të të cilave shuma e detyrimit përcaktohet në rast të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, për të cilat ai heq dorë nga kundërshtimet e rrethanave të ndryshme si dhe nga e drejta për të kërkuar uljen e tij mbi çdo bazë.

13.3. Për shumën e qirave të papaguara dhe për kompensimin e dëmit, me marrjen e njoftimit për zgjidhjen e Kontratës së Qirasë, Qiradhënësi ka të drejtë të shfrytëzimit të të gjitha fondeve të disponueshme për pagesë, përfshirë edhe shumën e garancisë.

14. KTHIMI I OBJEKTIT TË QIRASË/ VENDI DHE KOHA

14.1. Qiramarrësi angazhohet që pas përfundimit të afatit ose pas zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, objektin e qirasë t'ja kthejë Qiradhënësit në gjendje pune korrekte dhe të sigurt për qarkullim, në një shkallë vjetërsie e cila është e pritshme si rezultat i rrethanave normale dhe të zakonshme të përdorimit, me pajisje të kompletuara standarde, dokumentacion teknik, duke përfshirë librin e shërbimit dhe lejen e qarkullimit, dhe të gjithë çelësat.

Në rast të kundërt, ai merr përsipër të kompensojë të gjithë dëmin e vlerësuar nga ana e ekspertit të autorizuar (vlerësues i autorizuar ekspert i përhershëm gjyqësor i caktuar nga Qiradhënësi) ose nga një shitës i autorizuar i markës së automjetit të dhënë me qira, i cili do të përgatisë një pasqyrë të pjesëve të nevojshme për zëvendësim me një specifikimi i kostove të riparimit sipas listës së çmimeve të vlefshme të servisit të autorizuar. Në raste të veçanta, mund të bëjë vlerësimin edhe vetëfurnitori i automjetit specifik, i cili nuk është tregtar i autorizuar i një marke të caktuar, nëse zotëron një servis që mund të kryejë riparimet e nevojshme, me kusht që kostot të mos jenë më të larta se kostot që ofron një servis i autorizuar. Shpenzimet e çdo vlerësimi të objektit të dhënë me qira do të përballohen nga Qiradhënësi.

14.2. Qiradhënësi ka të drejtë që nga Qiramarrësi i cili e kthen automjetin në një gjendje që nuk i përgjigjet përdorimit të rregullt, të kërkojë kompensim të veçantë për dëmet, që mund të jenë në vlerën totale të të gjitha kësteve të qirave, vlerësim të cilin e bën një vlerësues i autorizuar i zgjedhur nga Qiradhënësi.

14.3. Nëse Qiramarrësi ka bërë disa ndryshime në objektin e qirasë (pajisje shtesë, përmirësime, etj.), përmirësimet e trupëzuara bëhen pronë e Qiradhënësit dhe Qiramarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim për ato shpenzime. Në atë rast, Qiramarrësi (duke hequr pjesët dhe/ose pajisjet), mund të rivendosë gjendjen e mëparshme në të cilën ishte objekti i dhënë me qira në kohën e lidhjes së Kontratës së Qirasë, me kusht që heqja e tyre nuk duhet të zvogëlojë vlerën dhe as funksionalitetin e objektit të dhënë me qira. Qiradhënësi mund të pranojë dhe vendosë të mbajë këto ndryshime (pajisje shtesë, përmirësime etj) pa kompensim.

14.4. Vendi dhe koha e kthimit të objektit të qirasë përcaktohet nga Qiradhënësi. Me rastin e kthimit të të objektit të qirasë, palët kontraktuese do të hartojnë një procesverbal për kthimin e të objektit të qirasë, i cili do të përcaktojë numrin e kilometrave të përshkuar në momentin e kthimit të objektit të qirasë dhe i cili liston të gjitha defektet e dukshme vizualisht, gjendjen e pajisjeve standarde, numrin e çelësve të kthyer, statusi i librezës së shërbimeve dhe lejen e qarkullimit. Gjendja e saktë e objektit të qirasë do të përcaktohet më pas brenda një kohe të arsyeshme me vlerësimin e ekspertit të autorizuar.

14.5. Nëse Qiramarrësi nuk kthen objektin e qirasë në datën mënyren e rene dakord midis paleve, Qiradhënësi është i autorizuar të organizojë kthimin e objektit të qirasë dhe lëshimin e dokumenteve të reja dhe të çelësve në emër e per llogari të qiramarrësit. Në një rast të tillë, do të konsiderohet se Qiramarrësi ose personi i autorizuar prej tij, është i vetedijshëm për pasojat e mundshme ligjore dhe penale që mund të vijne si rezultat i sjelljes së tij, dhe ai pranon përgjegjësinë penale në rast të sjelljes së tij në kundërshtim me ligjin nëse Qiramarrësi është person juridik për shkak të veprimeve kriminale kundrejt pasurisë. Qiramarrësi është gjithashtu përgjegjës se në këto raste Qiradhënësi mund të ngrejë akuza penale.

15. KOSTOT PËR KTHIMIN E OBJEKTIT TË QIRASË

15.1. Të gjitha kostot që mund të lindin për shkak të kthimit të objektit të qirasë do të ngarkohen Qiramarrësit. Qiramarrësi gjithashtu heq dore nga e drejta për të kërkuar kompensim për dëmin dhe kërkesat për ngarkimin e pagesave të qirasë tashme të shlyera dhe kosto të tjera. Në rast të marrjes së objektit të qirasë, Qiramarrësi është i detyruar të kompensojë të gjitha kostot lidhur me të deri në shumën e koston se lindur. Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë të gjitha kostot e udhëtimit përfaqësuesit të qiradhënësit ose personit të zgjedhur prej tij si dhe të gjitha kostot për marrjen e tij që do të thote kthimin e objektit të qirasë.

15.2. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë kompensim nga Qiradhënësi në rast se Qiramarrësi çaktivizon alarmin dhe pajisje të tjera të cilat parandalojnë funksionimin e objektit të qirasë dhe të cilat janë instaluar pa miratimin paraprak me shkrim të qiradhënësit. Qiradhënësi nuk është përgjegjës për sendet personale të gjetura në objektin e qirasë gjatë kthimit të objektit .

16. PËRLOGARITJA E DETYRIMIT/ VLERËSIMI I AUTOMJETIT

16.1. Pas përfundimit të afatit të Kontratës ose zgjidhjes së parakohshme të saj, Qiradhënësi do të llogarisë pagesat e qirasë të bëra deri në atë moment dhe të gjitha pagesat e tjera nga Kontrata, në bazë të të cilave do të përpilojë llogaritjen që do t'i dërgojë Qiramarrësit, me një kërkesë për të paguar të gjitha pretendimet e mbetura të papaguara nga ose të bazuara në Kontratë. Shuma e përcaktuar nga përlogaritja do të paguhet nga Qiramarrësi me një faturë të veçantë të dorëzuar nga Qiradhënësi në përputhje me përlogaritjen, brenda periudhës së specifikuar në atë faturë. Me skadimin e afatit të caktuar, Qiradhënësi është i autorizuar të aktivizojë të gjitha mjetet ekzistuese të garancisë për të siguruar pagesën e detyrimeve të Qiramarrësit.

16.2. Pas përfundimit të afatit të Kontratës së Qirasë do të përcaktohet gjendja e objektit të qirasë (vlerësuar nga një ekspert i autorizuar ose një vlerësim i përbashkët i gjendjes së automjetit, për të cilën asnjëra palë nuk ka kundërshtime) dhe në lidhje me këtë Qiramarrësi do të jetë i detyruar të kompensojë për kilometrazhin shtesë nëse kjo është konstatuar në vlerësim, si dhe për të kompensuar Qiradhënësin për të gjitha dëmtimet e automjetit që nuk janë rezultat i kushteve që mund të ndodhin normalisht në përputhje me mendimin e vlerësuesit/ekspertit të autorizuar ligjor.

17. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE

17.1. Të gjitha tarifatat, taksat, detyrimet dhe shpenzimet e tjera që lidhen me lidhjen ose me zgjidhjen e Kontratës, si dhe kostot e çdo marrëveshjeje të bërë nga palët kontraktuese, të cilat lindin gjatë kohëzgjatjes së Kontratës, pavarësisht se kur i janë llogaritur Qiramarrësit, do të përballohen nga Qiramarrësi.

17.2. Qiramarrësi merr përsipër të shlyejë të gjitha shpenzimet për të cilat do të ngarkohet Qiradhënësi (gjambat, tarifatat e avokatit, tarifatat gjyqësore dhe të tjera) të cilat janë shkaktuar nga ana e Qiramarrësit ose nga një person i tretë i autorizuar prej tij.

MBROJTJA E TË DHËNAVE

17.3 Qiradhënësi përpunon të dhënat personale të mbledhura nga Qiramarrësi, dorëzanësit dhe palët e treta që përdorin objektin e qirasë për qëllimin e ekzekutimit të Kontratës së Qirasë, në përputhje me Ligjin nr 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar (ne vijim "Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"). Qiradhënësi si anëtar e grupimit Porsche kryen shkëmbimin e të dhënave me themeluesin e saj Porsche Bank AG Austria, shoqëri e cila, si institucion financiar i regjistruar në Austri,

siguron një nivel adekuat të mbrojtjes së të dhënave dhe zbaton të gjitha standardet e parashikuara nga rregulloret e Bashkimi Evropian (GDPR). Mbledhja e të dhënave është një kusht i domosdoshëm për lidhjen e një Kontrate Qiraje dhe në rast se Qiramarrësi ose dorëzanësi refuzon të japë të dhënat e nevojshme personale, Kontrata e Qirasë nuk mund të lidhet, duke pasur parasysh se këto të dhëna janë të domosdoshme për zbatimin e Kontratës.

17.4 Të dhënat që mbledhen ruhen për 10 vjet pas përfundimit të Kontratës së Qirasë, pra pas përbushjes së plotë të detyrimeve kontraktuale. Në rast të mospërbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktuale, Qiradhënësi mund t'i ruajë të dhënat e mbledhura deri në përfundimin e procedurave përkatëse gjyqësore.

TË DREJTAT E INDIVIDËVE TË DHËNAT E TË CILËVE PËRPUHOHEN, NË LIDHJE ME MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

17.5 E drejta për të revokuar pëlqimin Individit, të cilit i përkasin të dhënat, ka të drejtë të revokojë pëlqimin në çdo kohë. Revokimi i pëlqimit nuk ndikon në pranueshmërinë e përpunimit që është kryer në bazë të pëlqimit përpara revokimit. Përpara dhënies së pëlqimit, personi të cilit i referohen të dhënat duhet të informohet për të drejtën e revokimit, si dhe efektin e revokimit. Tërheqja e pëlqimit duhet të jetë po aq e lehtë sa dhënia e pëlqimit. Qiradhënësi nuk i përpunon të dhënat e Qiramarrësve, garantuesve të përbashkët dhe palëve të treta që përdorin automjete në bazë të pëlqimit të Qiramarrësit, por për qëllim ekzekutimit e kësaj marrëveshjeje qiradhënieje.

17.6 E drejta e aksesimit Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që të kërkojë nga Qiradhënësi informacion nëse ajo përpunon të dhënat e tij personale, aksesimin në ato të dhëna, si dhe informacione për qëllimin e përpunimit, për llojet e të dhënave personale. Të dhënat që përpunohen, mbi individët të cilëve u janë zbuluar ose do t'u zbulohen të dhënat personale, për periudhën e pritshme të ruajtjes së të dhënave personale, ose nëse kjo nuk është e mundur, për kriteret për të përcaktuar këtë periudhë, mbi ekzistencën e së drejtës për t'i kërkuar kontrolluesit të korrigjorë ose fshijë të dhënat e tij për personin, të drejtën për të kufizuar përpunimin dhe të drejtën për të kundërshtuar përpunimin, për të drejtën për të paraqitur një ankesë tek Komisioneri për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale (ne vijim "Komisioneri"), dhe për ekzistencën e një procedure të automatizuar vendimmarrjeje, duke përfshirë profilizimin.

17.7 E drejta e fshirjes Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që të kërkojë nga Qiradhënësiqë të dhënat e tij personale nga operatori. Qiradhënësi është i detyruar që pa vonesa të panevojshme të fshijë të dhënat e mbledhura brenda periudhës së lartpërmendur, në rastet kur të dhënat personale nuk janë më të nevojshme për të arritur qëllimin (ekzekutimin e marrëveshjes së qirasë) qëllim për të cilin janë mbledhur ose përpunuar.

17.8 Detyrimi për njoftim në lidhje me korrigjimin ose fshirjen e të dhënave, si dhe kufizimin e përpunimit të të dhënave. Qiradhënësi është i detyruar të informojë të gjithë individët të cilëve u janë zbuluar të dhënat personale për çdo korrigjim ose fshirje të të dhënave personale ose kufizim të përpunimit të tyre në përputhje me ligjin, përveç rasteve kur është e pamundur ose kërkon një shpenzim të tepruar kohe dhe burimesh.

17.9 E drejta për kufizimin e përpunimit të të dhënave Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që të kufizojë përpunimin e të dhënave të tij personale nga operatori nëse personi të cilit i referohen të dhënat konteston saktësinë e të dhënave personale, brenda një periudhe që lejon operatorin për të kontrolluar saktësinë e të dhënave personale, nëse përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, dhe personi të cilit i referohen të dhënat kundërshton fshirjen e të dhënave personale dhe në vend të fshirjes kërkon kufizimin e përdorimit të të dhënave, nëse operatori nuk ka më nevojë të dhënat personale

Porsche Leasing Sh.p.k.

për të arritur qëllimin e përpunimit, por personi të cilit i referohen të dhënat e ka kërkuar atë për të paraqitur, realizuar ose mbrojtur një pretendim ligjor, nëse personi të cilit i referohen të dhënat ka paraqitur një kundërshtim lidhur me përpunimin dhe në proces është vlerësimi, nëse baza ligjore për përpunimin nga ana e operatorit tejkalon interesat e atij personi.

17.10 E drejta për transferueshmërinë e të dhënave Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që të marrë të dhënat e tij personale dorëzuar më parë Qiradhënësi në një formë të strukturuar, të përdorshme mormalisht dhe të lexueshme në mënyrë elektronike dhe ka të drejtë t'i transferojë këto të dhëna te një operator tjetër pa u penguar nga Qiradhënësi, të cilit i janë dorëzuar të dhënat, nëse përpunimi bazohet në pëlqim ose në bazë të kontratës dhe nëse përpunimi kryhet në mënyrë automatike. Kjo e drejtë përfshin gjithashtu të drejtën e një personi që të dhënat e tij personale menjëherë të transferohen tek një operator tjetër nga operatori të cilit i janë dorëzuar më parë këto të dhëna, nëse kjo është teknikisht e realizueshme.

17.11 E drejta për të kundërshtuar Nëse e konsideron të justifikuar në lidhje me situatën e veçantë në të cilën ndodhet, individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që në çdo moment të paraqesë një kundërshtim për përpunimin e të dhënave të tij personale nga Qiradhënësi. Operatori është i detyruar të ndërpresë përpunimin e të dhënave për personin që ka paraqitur ankesën, përveç nëse ai ka paraqitur se ekzistojnë arsye ligjore për përpunimin që mbizotërojnë mbi interesat, të drejtat ose liritë e individit të cilit i referohen ose lidhen me të dhënat. paraqitjen, ushtrimin ose mbrojtjen e kërkesave ligjore. Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë që të kundërshtojë në çdo kohë përpunimin e të dhënave të tij personale që përpunohen për qëllime të reklamimit të drejtpërdrejtë, përfshirë edhe profilizimin, në masën që lidhet me reklamimin e drejtpërdrejtë. Nëse individit, të cilit i përkasin të dhënat kundërshton përpunimin për qëllime të reklamimit të drejtpërdrejtë, të dhënat personale nuk mund të përpunohen më për qëllime të tilla.

17.12 Vendmarrja e automatizuar e disa vendimeve dhe profilizimi Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë të mos zbatojë një vendim të marrë vetëm në bazë të përpunimit të automatizuar, përfshirë edhe profilizimin, nëse ai vendim prodhon pasojë ligjore për atë person ose ai vendim ndikon ndjeshëm në pozicionin e tij. Kjo e drejtë nuk zbatohet nëse vendimi është i nevojshëm për lidhjen ose për ekzekutimin e një marrëveshjeje ndërmjet individit, të cilit i përkasin të dhënat dhe Qiradhënësi.

17.13 E drejta për ankimim te Komisioneri Individit, të cilit i përkasin të dhënat ka të drejtë të ankohet pranë Komisionerit për të dhënat me rëndësi publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale, në adresën:

Rr. "Abdi Toptani", Nd. 5, Kodi postar 1001, Tiranë
Telefon +35542237200, e mail: info@idp.al,

nëse konsideron se përpunimi i të dhënave të tij personale është kryer në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Denoncimi pranë Komisionerit nuk cenon të drejtën e këtij personi për të nisur procedura të tjera administrative apo gjyqësore për mbrojtje.

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR QIRAMARRËSIT DHE PËRFAQËSUESIT DHE PERSONAT E LIDHUR QË GJENDEN NË LISTAT E PERSONAVE SANKSIONUAR NGA ORGANIZATAT NDËRKOMBËTARE DHE/OSE AUTORITETET E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, qiramarrësi konfirmon që bazuar në informacionet e tij se as shoqëria që ai përfaqëson, as shoqëria e lidhur apo ndonjë prej drejtorëve apo zyrtarëve përgjegjës të saj,

domethënë përfaqësuesit:

- (i) nuk është një palë që është objekt i ndonjë kufizimi në biznes (në tekstin vijues "palë me kufizime");
- (ii) nuk është përfshirë në ndonjë transaksion, aktivitet ose sjellje për shkak të të cilave, në mënyrë të arsyeshme pritet që ajo të bëhet "palë me kufizime";
- (iii) nuk merr pjesë në asnjë transaksion, aktivitet ose sjellje që mund të çojë në shkeljen e sanksioneve të zbatueshme të parashikuara nga vendimet e organizatave ndërkombëtare apo të Shqipërisë;
- (iv) nuk ka marrë njoftim ose është në dijeni të ndonjë kërkesë, aktiviteti, procedimi apo hetimi gjyqësor ose hetimi tjetër në lidhje me sanksionet e institucioneve dhe/ose autoriteteve ndërkombëtare apo autoriteteve të Republikës së Shqipërisë;
- (v) nuk vepron në emër ose me urdhër të ndonjë "pale me kufizime" në lidhje me objektin e qirasë të mbuluar të cilit i referohet kjo marrëveshje.

Qiramarrësi me marrëveshje detyron qiradhënësin që:

- (i) nuk kontribuon ose nuk vë në dispozicion të ardhurat e tij totale ose ndonjë pjesë të atyre të ardhurave që ajo fiton në bazë të objektit të qirasë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ose ia beson ato në dobi të ndonjë individit ose subjekti për qëllime financimi aktivitetet ose transfertat, transaksionet ose investimet e tjera të ndonjë "pale me kufizime";
- (ii) nuk financon drejtpërdrejt ose tërthorazi, tërësisht ose pjesërisht, shlyerjen ose shlyerjen e parakohshme të qirasë nga të ardhurat e çdo transaksioni ose aktiviteti që përfshin "palën me kufizime";
- (iii) të mos përfshihen në asnjë transaksion, aktivitet ose sjellje që do të përbënte shkelje të sanksioneve të zbatueshme ndaj tyre; ose
- (iv) nuk angazhohet në ndonjë transaksion, aktivitet ose sjellje që do të bënte që Porsche Mobility shpk ose një anëtar tjetër të Grupit Porsche të shkelte ndonjë sanksion ose që në mënyrë të arsyeshme mund të presë të kontribuojë në një shkelje të tillë që do të shkaktonte trajtimin e qiramarrësit si "palë me kufizime".

Përdorimi i të ardhurave

Qiramarrësi merr përsipër të sigurojë që asnjë nga palët e lidhura me të, nuk do të:

(i) përdorë, japë hua, kontribuojë ose vejë në dispozicion të gjitha apo ndonjë pjesë të të ardhurave nga çdo hua ose transaksion tjetër i parashikuar në Dokumentin e transaksionit drejtpërdrejt ose tërthorazi:

(A) për çdo financim ose lehtësim të çdo tregtie, biznesi ose aktiviteti tjetër në masën që ky financim ose lehtësim i një aktiviteti tjetër do të ndalohej nga sanksionet ose do të shkaktonte përndryshe shkeljen e sanksioneve nga ndonjë person,

(B) në çdo mënyrë tjetër në të cilën çdo person, duke përfshirë, por pa u kufizuar vetëm tek Qiramarrësi, pritet në mënyrë të arsyeshme të shkelë ndonjë sanksion ose të bëhet palë e sanksionuar;

(ii) marrin pjesë në çdo transaksion që shmang, ose shkel, ose synon të shmangë, ose tenton të shkelë, drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo sanksion të vendosur nga organizatat ndërkombëtare ose nga autoritetet e Shqipërisë;

(vi) financon tërësisht ose pjesërisht shumat e detyrimeve në lidhje me Dokumentin e Transaksionit nga procedura që rrjedh nga çdo veprim në lidhje me shkeljen e Sanksionit;

Qiramarrësi duhet të ketë kontrollin dhe proceset e duhura të konceptuara për të parandaluar çdo aktivitet që nuk është në përputhje me sa më sipër.

Qiramarrësi do të krijojë dhe mbajë politika dhe procedura të përgatitura në mënyrë të arsyeshme për të nxitur dhe arritur pajtueshmërinë me sanksionet e përcaktuara të organizatave ndërkombëtare dhe autoriteteve të Republikës së Shqipërisë në përputhje me sanksionet e aplikueshme.

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

Përkufizime me rëndësi për dispozitat e mësipërme

“Palë me kufizime” do të thotë çdo individ ose ent që:

(i) është i listuar si, në pronësi ose si i kontrolluar (pasi termat e tillë, duke përfshirë çdo formë të zbatueshme të pronësisë dhe kontrollit, përcaktohen dhe interpretohen në ligjet dhe rregulloret e zbatueshme të sanksioneve ose në ndonjë udhëzim zyrtar në lidhje me ligje dhe rregullore të tilla sanksionesh) nga një person në listën e sanksioneve,

(ii) qeveria e vendit të sanksionuar,

(iii) një agjenci ose instrument, ose një ent në pronësi ose kontroll direkt ose indirekt, të vendit të sanksionuar nga qeveria,

(iv) banon ose ndodhet në një vend të sanksionuar, kryen aktivitete nga ai vend ose është themeluar në përputhje me ligjin e një vendi të sanksionuar, (c) sipas informacioneve të qiramarrësit ose shoqërisë mëmë objektiv i sanksioneve, ose me të cilin qiradhënësi ka përfaqësuar bashkëpunim në shkelje të sanksioneve.

“Sanksion” nënkupton një sanksion ekonomik ose financiar ose embargo tregtare ose ndalim tjetër sipas ligjeve kundër terrorizmit ose embargos burimore që rregullojnë sjelljen e vendosur, administruar ose zbatuar nga çdo Autoritet Sanksionesh.

“Vend i sanksionuar” nënkupton çdo vend ose territor tjetër që është objekt i një embargoje të përbashkët eksporti, importi, financiar ose investimi në lidhje me çdo sanksion që fillon në datën e kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë Krimenë (siç përcaktohet dhe interpretohet sipas rregulloreve të zbatueshme të sanksioneve) jo-palët jashtë kontrollit nga qeveria në zonat e Donetsk dhe Lugansk në Ukrainë, Krime, Kubë, Iran, Korenë e Veriut dhe Siri.

“Institucionet që vendosin sanksione” do të thotë (i) Shtetet e Bashkuara, (ii) Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, (iii) Bashkimi Evropian ose ndonjë nga shtetet e tij anëtare, (iv) Mbretëria e Bashkuar (v) autoritetet e Republikës së Shqipërisë ose (v) institucionet kompetente qeveritare të cilto nga institucionet e mësipërme, duke përfshirë, pa kufizim, Thesarin e Madhërisë së Saj, Zyrën e Ministrisë së Financave të SHBA për Kontrollin e Pasurive Jashtë vendit, Ministrinë e Tregtisë së SHBA-së, Departamentin e Shtetit të SHBA-së dhe çdo agjenci tjetër të qeverisë së SHBA.

“Lista e sanksioneve” nënkupton çdo listë të shtetasve të caktuar posaçërisht ose individëve ose subjekteve të përcaktuara ose të sanksionuara (ose ekuivalente të tyre) të lëshuara nga çdo institucion sanksionues, të ndryshuar, plotësuar ose zëvendësuar në mënyrë periodike.

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Në ditën e nënshkrimit të Kontratës së Qirasë, pjesë përbërëse e së cilës janë këto AKP, Qiramarrësi merr përsipër të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga Kontrata dhe AKP.

Të gjitha ndryshimet dhe shtesat në Kontratë do të bëhen nga palët me shkrim, si është kusht për vlefshmërinë e tyre, me përjashtim të rasteve të përmendura në dispozitat e Nenit 5.4 të AKP.

Qiradhënësi mund të transferojë të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate tek një pale e trete pa cenuar të drejtat e Qiramarrësit sipas kësaj Kontrate. Në një rast të tillë Qiramarrësi nuk mund të zgjidhë Kontratën.

Në rast të mosmarrëveshjeve midis palëve lidhur me interpretimin dhe/ose zbatimin e kësaj Kontrate e cila nuk mund të zgjidhët në negociatë midis paleve, këto mosmarrëveshje do të zgjidhën nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Palët kontraktuese bien dakord që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese i nënshtrohen AKP.

Qiramarrësi konfirmon me nënshkrimin e tij se ka lexuar dhe pranuar të gjitha kushtet e Kontratës dhe AKP dhe planin e pagesës së qirasë, të cilat të gjitha janë pjesë përbërëse e Kontratës.

Qiramarrësi (personi fizik) deklaron dhe konfirmon me nënshkrimin e tij se e lidh Kontratën e Qirasë në emër dhe për llogari të tij dhe se nuk ka marrëdhënie të fshehura kreditori me persona të tjerë juridikë

dhe/ose fizikë bazuar në lidhjen e kësaj Kontrate. Përfaqësuesi ligjor i qiramarrësit (subjekti juridik) deklaron dhe konfirmon me nënshkrimin e tij se ai/ajo ka lidhur Kontratën/at e Qirasë në emër dhe për llogari të personit juridik-Qiramarrësit, si dhe që nuk ka marrëdhënie të fshehura kreditori me persona të tjerë juridikë dhe/ose fizikë bazuar në lidhjen e kësaj Kontrate.

Kjo Kontratë është nënshkruar në 4 (katër) kopje identike, 3 (tre) për Qiradhënësin dhe 1 (një) për Qiramarrësin.

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr.llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

PJESA I- DISPOZITAT E PËRGJITHSHME PËR KUSHTET OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHITESË

1.1 Porsche Leasing SHPK si Qiradhënës (në tekstin vijues PL) dhe Qiramarrësi (në vijim "Qiramarrësi"), konfirmojnë Kushtet e Ofritit të Shërbimeve Shtesë, (në vijim "Kushtet e Ofritit të Shërbimeve Shtesë" ose "Kushtet") mbi bazën e Kontratës së Qirasë (në vijim "Kontrata e Qirasë" ose "Kontrata") si dhe mënyrën e ofritit dhe pagesës së shërbimeve shtesë.

1.2 Kushtet e Ofritit të Shërbimeve Shtesë janë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë, dhe aplikohen vetëm për shërbimet, për të cilat është rënë dakord në Kontratën e Qirasë, me objekt ofrimin e shërbimeve shtesë.

1.3 Shërbimet shtesë kontraktohen me Kontratën e Qirasë së automjetit, sipas modelit më poshtë:

- **Shërbimet shtesë të ndryshueshme** - nëpërmjet këtij modeli Qiramarrësi angazhohet që tarifat për shërbimet e kontraktuara t'i paguajë në shumat e përcaktuara me Kontratën e Qirasë, por këto shuma gjatë periudhës së kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë, mund të ndryshohen në përputhje me shpenzimet reale të shërbimeve të kontraktuara. Shumat e tarifave për shërbimet e kontraktuara do të ndryshohen periodikisht në kohën dhe në mënyrën e parashikuar në këto Kushte, e kjo të paktën një herë në vit, si dhe në fund të periudhës për të cilën është kontraktuar ofrimi i këtyre shërbimeve.

PJESA II- DETYRIMET E PORSCHE LEASING SHPK

2. OFRIMI I SHËRBIMEVE SHITESË

2.1 PL mbi bazën e Kontratës së Qirasë, krahas me të drejtën për përdorimin e automjetit, i ofron Qiramarrësit shërbimet shtesë si më poshtë:

-Shërbimi i Mirëmbajtjes së Automjetit- nënkupton mirëmbajtje periodike dhe shtesë, si dhe riparime të jashtëzakonshme në automjet, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit, përcaktuar nga Kontrata e Qirasë dhe në përputhje me këto Kushte.

-Shërbimi i Mirëmbajtjes së Gomave të Automjetit- nënkupton furnizimin (blerjen) e gomave sipas numrit dhe klasave të përcaktuara nga Kontratës e Qirasë, magazinimin, montimin, organizimin e ndërrimeve sezonale të gomave, në përputhje me këto Kushte.

-Kompensimi i Shpenzimeve të Regjistrimit të Automjetit- nënkupton që PL, do të përballojë të gjitha shpenzimet e lidhura me regjistrimin (kontrolli teknik, taksat administrative, shpenzimeve për nxjerrjen e targave, nxjerrjen e lejes së qarkullimit për automjetet e regjistruara për herë të parë, taksat vjetore dhe taksën e luksit (nëse është e aplikueshme).

- Kompensimi i Shpenzimeve të policës së sigurimit TPL- nënkupton që PL, do të sigurojë dhe do të përballojë shpenzimet e policës së sigurimit, për sigurimin e detyrueshëm TPL, shpenzime të cilat Qiramarrësi do t'i kompensojë bashkë me qiratë mujore, në përputhje me Kontratën.

- Kompensimi i Shpenzimeve të policës së sigurimit Kasko- nënkupton që PL, në përputhje me kushtet e shoqërisë së sigurimeve, kushte me të cilat Qiramarrësi u njoh më përpara në tërësi dhe ra dakord pranë shoqërisë së sigurimeve, do të paguajë shpenzimet totale për sigurimin kasko, shpenzime të cilat Qiramarrësi do t'i kompensojë bashkë me qiratë mujore, në përputhje me Kontratën.

-Shërbimi i Automjetit Zëvendësues- nënkupton mundësinë e

përdorimit të një automjeti zëvendësues në situatat dhe në masën që është përcaktuar nga Kontrata e Qirasë, dhe në përputhje me këto Kushte.

-Shërbimi i marrjes dhe dorëzimit të Automjetit- nënkupton që mjeti që është objekt i qirasë do të merret sipas nevojës, me qëllim ndërrimin e gomave të automjetit, servisit e rregullt, kontrollin e rregullt teknik, dhe do të dorëzohet Qiramarrësit pas kryerjes së këtyre shërbimeve.

-Shërbimi i Asistencës së flotës- nënkupton auto rimorkim deri tek servisi i autorizuar, në situatat dhe Vëllimin e përcaktuar në Kontratën e Qirasë dhe në përputhje me këto Kushte.

-Shërbimi i paisjes GPS- nënkupton montimin dhe instalimin e paisjes GPS/GPRS, shërbimin e ofritit të asistencës teknike në lidhje me gjurmimin e automjetit me ndihmën e paisjes GPS/GPRS, servisimin e paisjes GPS/GPRS, akses i vazhdueshëm në gjurmimin e automjeteve, nëpërmjet qendrës së kontrollit.

- Shpërbimi për Karton Jeshil ose ofrimi i shërbimeve një herë me kërkesë të Qiramarrësit- nënkupton që PL do të përballojë shpenzimet lidhur me kërkesën e Qiramarrësit për lëshimin e dokumentacionit të nevojshëm, larjen e automjeteve dhe shërbime të tjera për një herë, ndërsa Qiramarrësi merr përsipër që mbi këtë bazë të paguajë shpenzimet e parafaturuara një herë përmes faturës së parë pasuese, të shtuara me një tarifë të përshtatshme, nëse kështu është rënë dakord ndërmjet palëve, pas pranimit të kërkesës.

-Tarifa e menaxhimit të shërbimeve- nënkupton administrimin në lidhje me objektin e qirasë, mbështetjen logjistike dhe menaxhimin e ngjarjeve të padëshiruara (këshilla në momentin e shfaqjes së një ngjarje të pafavorshme, likuidimi/arkëtimi i dëmeve, përzgjedhja e shërbimeve të riparimit), si dhe raporte të tjera sipas zgjedhjes së Qiramarrësit.

2.2 PL do të mundësojë shërbime, nëse për këto është dakordësuar nëpërmjet Kontratës së Qirasë, në përputhje me këto Kushte. Niveli, Vëllimi dhe mënyra e ofritit të secilit prej shërbimeve shtesë, përcaktohet në Kontratën e Qirasë dhe në përputhje me këto Kushte.

2.3 Në rast se Qiramarrësi me Kontratën e Qirasë, nuk ka kontraktuar disa nga shërbimet e renditura në Nenin 2 të këtyre Kushteve, përjashtohet zbatimi i dispozitave të Kushteve, në të cilat specifikohen shërbimet e pakontraktuara.

3. SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË AUTOMJETIT

3.1 Shërbimi shtesë i mirëmbajtjes së automjetit nënkupton riparimet e nevojshme periodike, shtesë dhe të jashtëzakonshme në automjet, duke përfshirë ndërrimin e pjesëve të nevojshme rezervë në përputhje me udhëzimet e prodhuesit të automjetit, dhe PL është i detyruar të ofrojë këtë shërbim vetëm nëse kjo është dakordësuar shprehimisht në Kontratën e Qirasë, në situatat dhe në Vëllimin e përcaktuar me Kontratën e Qirasë, dhe në përputhje me këto Kushte.

3.2 PL dhe Qiramarrësi, me Kontratën e Qirasë, kontraktajn një nga tri nivelet e shërbimit të mirëmbajtjes, si më poshtë:

1) Mirëmbajtja periodike e automjetit nënkupton servisimin periodik të objektit të qirasë sipas planit të prodhuesit të automjetit (ndërrimi i vajit dhe filtrave).

2) Mirëmbajtja periodike dhe mirëmbajtja shtesë e automjetit përfshin servisimin periodik të objektit të qirasë sipas

Porsche Leasing Sh.p.k.

planit të prodhuesit të automjetit (ndërrimi i vajit dhe filtrave) dhe zëvendësimi i pjesëve të konsumit në automjet për shkak të konsumit normal (ndërrimi i ferrotave dhe disqeve të frenave, fshirësit të xhamave, llambave, freksionit).

3) Mirëmbajtja periodike, mirëmbajtja shtesë, dhe mirëmbajtja e plotë përfshin servisimin periodik të objektit të qirasë sipas planit të prodhuesit të automjetit (ndërrimi i vajit dhe filtrave) dhe zëvendësimi i materialeve të konsumit në automjet për shkak të konsumit normal (ndërrimi i ferrotave dhe disqeve të frenave, fshirësit të xhamave, llambave, freksionit) dhe riparime të jashtëzakonshme të automjetit, përveç nëse janë përjashtuar me ndonjë prej dispozitave të Nenit 3.4 të këtyre Kushteve .

3.3 Në kuadrin e shërbimit të mirëmbajtjes të përmendur në këtë nen, nënkuptohet që PL do të pajisë automjetin me pajisje të detyrueshme në përputhje me rregulloret që lidhen me sigurinë në qarkullimin rrugor, kutia e ndihmës së shpejtë, dhe tapeti i dyshemesë së automjetit.

3.4 Në kuadrin shërbimit të mirëmbajtjes së automjetit, nuk përfshihen:

- riparime dhe mirëmbajtje duke përdorur pjesë jo origjinale, dhe/ose pjesë që nuk rekomandohen nga prodhuesi të objektit të qirasë,
- riparimet dhe eliminimi i dëmeve të shkaktuara nga joprofesionistë, mirëmbajtjen dhe ndërhyrjen në automjet nga Qiramarrësi ose palë të treta (si riparime dhe ndërhyrje joprofesionale konsiderohen të gjitha riparimet dhe ndërhyrjet që nuk janë kryer në serviset e autorizuara të prodhuesit të objektit të qirasë),
- riparimet për shkak të dëmtimit të automjetit në rastet kur nuk dihet se si ka ndodhur dëmtimi,
- pjesët e këmbimit dhe riparimet të cilat janë objekt i dëmeve të mbuluara nga polica e sigurimit,
- pjesët e këmbimit dhe riparimet për të cilat siguruesi me të cilin objekti i qirasë është plotësisht i siguruar në përputhje me kushtet e sigurimit, refuzoi të paguajë dëmin e shkaktuar,
- defekte të mbuluara nga garancia ose që përfshihen në garanci,
- çdo instalim i mëvonshëm i pajisjeve të brendshme, radios, sistemit të navigimit, tapiceri, etj.,
- shpenzimet për shërbimin e rimorkimit,
- dëmtimi i trupit të automjetit (karrocisë), boja dhe dëmtimi nga ndryshku,
- eliminimin e dëmtimeve dhe riparimet e shkaktuara nga pakujdesia e shoferit,
- defektet e shkaktuara si rezultat i furnizimit me llojin e gabuar të karburantit në rezervuarin e automjetit.

3.5 Nëse ka ndonjë paqartësi lidhur me, nëse shërbimi shtesë i kontraktuar i automjetit mbulon riparimin e dëmeve, për disa shërbime të tjera, vendimi merret nga eksperti i autorizuar nga PL. Qiramarrësi është i detyruar të paguajë shpenzimet e personit të përmendur duke përfshirë edhe detyrimet tatimore përkatëse, nëse rezulton se bëhet fjalë për riparimin e dëmeve ose ofrimin e shërbimeve që nuk mbulohen nga këto Kushte.

3.6 Nëse ekzistojnë disa mundësi për kryerjen e shërbimeve në servis, PL vendos bazuar në arsyetimin ekonomik.

4. SHËRBIMI I MIRËMBAJTJES SË GOMAVE TË AUTOMJETIT

4.1 Shërbimi shtesë i mirëmbajtjes së gomave të automjetit nënkupton blerjen, ruajtjen, montimin, organizimin dhe zëvendësimeve sezonale të gomave, dhe PL është i detyruar të ofrojë këtë shërbim, nëse kjo parashikohet nga Kontrata e Qirasë në

situatat dhe Vëllimin e përcaktuar nga Kontrata, dhe në përputhje me këto Kushte.

4.2 PL dhe Qiramarrësi në Kontratën e Qirasë kanë rënë dakord për njërin nga dy modelet e mëposhtme:

1) Një numër të kufizuar gomash- nënkupton blerjen e një numri të caktuar gomash dimërore dhe/ose verore standarte, që nënkupton gomat e përmasave me të cilat prodhuesi e dorëzoi automjetin në fillim. Numri dhe klasa e gomave përcaktohet me marrëveshje. Blerja e gomave të kontraktuara kryhet sapo thellësia e përcaktuar e profilit në gomat e mëparshme të arrijë minimumin e përcaktuar ligjërisht.

2) Një numër i pakufizuar gomash- nënkupton blerjen e një numri të pacaktuar gomash dimërore dhe/ose verore standarde, që nënkupton gomat e përmasave me të cilat prodhuesi e dorëzoi automjetin në fillim, deri në përfundim të periudhës së Kontratës. Numri dhe klasa e gomave përcaktohet në varësi të nevojave reale për ndërrimin e tyre, në varësi të kilometrazhit vjetor dhe të në varësi të profilit minimal të thellësisë, të përcaktuar me ligj. Blerja e grupeve të gomave të kontraktuara kryhet sapo thellësia e përcaktuar e profilit në grupet e mëparshme të gomave të arrijë minimumin e përcaktuar ligjërisht.

Nëse është kontraktuar shërbimi shtesë për mirëmbajtjen e gomave të automjetit, PL përveç sa më sipër do të ofrojë:

- ndërrim sezonal i gomave (një herë në vit ndërrimi i gomave verore me ato dimërore dhe i gomave dimërore me ato verore);
- montimi i gomave dhe balancimi në një makinë balancuese kur ndërrohet, domethënë balancimi për devijimet e gomave, shkaktuar në varësi të kushteve;
- shërbimit të magazinimit/ruajtjes të gomave;
- ri-alokimin e gomave në objekt tjetër në varësi të kërkesave të Qiramarrësit e në varësi të mundësive të PL.

4.3 PL për nevojat e blerjes së gomave dhe montimin, do të zgjedhë funitorin sipas nevojave të Qiramarrësit dhe në përputhje me kapacitetet e PL.

4.4 PL dhe Qiramarrësi njëzëri konfirmojnë që me nënshkrimin e Kontratës së Qirasë, me të cilën është dakordësuar edhe ofrimi i shërbimeve shtesë i mirëmbajtjes së gomave, shuma e shpërbllimit lidhur me këtë shërbim, tek modeli me numrin e pacaktuar të gomave, caktohet në përputhje me kilometrazhin vjetor të cituar në Kontratën e Qirasë, ndërkohë që tek modeli me numër të kufizuar gomash, kjo bazohet në numrin e gomave të kontraktuara.

4.5 Nëse kontraktohet modeli me një numër të pakufizuar të gomave, dhe nëse gjatë zbatimit të Kontratës ndodhin ndryshime në kilometrazhin vjetor të rënë dakord, ose nëse me objektin i qirasë kryhet një kilometrazh më i lartë sesa ato të kontraktuara, PL është i autorizuar që në përputhje me dispozitën e nenit 1.3 të këtyre Kushteve, të ndërpesë ofrimin e mëtejshëm të këtij shërbimi, përveç nëse palët nënshkruajnë dhe pranojnë të ndryshojnë shumën fikse mujore të dakordësuar për ofrimin e këtij shërbimi. Në rast të përfundimit të ofrimit të këtij shërbimi, cituar në këtë nen, Qiramarrësi e ka për detyrë të vijojë me pagesën e shpërbllimit të dakordësuar, deri në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë, në çdo element siç është parashikuar me Kontratën e Qirasë.

5. KOMPENSIMI PËR SHPENZIMET E REGJISTRIMIT TË OBJEKTIT TË QIRASË

5.1 Kompensimi i shpenzimeve të regjistrimit të objektit të qirasë, nënkupton që PL gjatë regjistrimit të automjetit, paguan të gjitha shpenzimet që lidhen me regjistrimin (kontrolli teknik, tarifat

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

administrative, shpenzimet e targave dhe lejeve të qarkullimit në rastin e regjistrimit për herë të parë, taksën vjetore dhe taksën e luksit, nëse është e aplikueshme). Kostot e përmendura Qiramarrësi do t'i paguajë nëpërmjet pagesës së tarifës së regjistrimit të objektit të qirasë në shumat e përcaktuara në Kontratën e Qirasë së automjetit gjatë periudhës së qirasë.

6. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË SIGURIMIT TË DETYRUAR TË AUTOPËRGJEGJËSISË (TPL)

6.1 Rimbursimi i shpenzimeve të sigurimit të detyruar të autopërgjegjësive TPL nënkupton që PL në përputhje me kushtet e shoqërisë së sigurimeve, do të sigurojë dhe të përballojë kostot e sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësive për një automjet që është objekt i Kontratës së Qirasë, për të cilin PL është i detyruar ta sigurojë nëse është rënë dakord shprehimisht në Kontratën së Qirasë dhe në përputhje me këto Kushte.

6.2 Shpenzimet e mësipërme do të paguhet nga Qiramarrësi nëpërmjet kompensimit për kostot e sigurimit të autopërgjegjësive në shumat mujore të përcaktuara në Kontratën së Qirasë gjatë gjithë kohëzgjatjes së saj.

7. KOMPENSIMI I SHPENZIMEVE TË SIGURIMIT KASKO TË OBJEKTIT TË QIRASË

7.1 Rimbursimi i shpenzimeve të sigurimit kasko të automjetit objekt i qirasë, nënkupton që PL në përputhje me kushtet e shoqërisë së sigurimeve me të cilat Qiramarrësi është njohur më parë plotësisht dhe ka rënë dakord, me shoqërinë e sigurimit, të përballojë kostot totale të sigurimit kasko të mjetit që është objekt i Kontratës së Qirasë, që PL është i detyruar t'i sigurojë nëse është parashikuar shprehimisht nga Kontrata dhe në përputhje me këto Kushte. Kontrata e Qirasë së automjetit do të emërojë kompaninë e sigurimit me të cilën do të kontraktohet sigurimi Kasko, si dhe shumën e pjesëmarrjes në dëmshpërblim sipas policës së sigurimit kasko.

7.2 Me pranimin e ofertës së kompanisë siguruese, nga ana e PL dhe Qiramarrësit, do të pranohen në sigurimin kasko, të gjitha elementët thelbësorë të Kontratës, duke përfshirë pjesëmarrjen në dëm, i cili do të përballohet nga vetë Qiramarrësi. Shpenzimet e sigurimit kasko dhe shpenzime të tjera të listuara, nëse kontraktohen, do të rimbursohen nga Qiramarrësi, duke paguar tarifën mujore të sigurimit kasko, bashkë me shumat e deklaruara në Kontratën e Qirasë së automjetit gjatë periudhës së Kontratës së Qirasë.

8. SHËRBIMI I AUTOMJETIT ZËVENDËSUES

8.1 Shërbimi shtesë i automjetit zëvendësues, nënkupton mundësinë e përdorimit të një automjeti zëvendësues, dhe ky shërbim detyrohet të ofrohet nga PL nëse është rënë dakord shprehimisht në Kontratën e Qirasë, në situatat dhe Vëllimin e përcaktuar nga Kontrata e Qirasë, dhe në përputhje me këto Kushte.

8.2 PL dhe Qiramarrësi, me Kontratën e Qirasë, do të dakordësojnë njërin nga dy modelet më poshtë, prej shërbimeve të automjetit zëvendësues:

1) numër të kufizuar të ditëve të përdorimit të automjetit zëvendësues, nënkupton një model shërbimi sipas të cilit Qiramarrësi do të jetë në gjendje të përdorë një automjet zëvendësues në situatat kur objekti i qirasë është jashtë funksionit për shkaqe objektive, por kjo, për një numër të kufizuar ditësh, i cili parashikohet në Kontratën e Qirasë së automjetit.

2) numër të pakufizuar të ditëve të përdorimit të automjetit zëvendësues, nënkupton një model shërbimi sipas të cilit Qiramarrësi do të jetë në gjendje të përdorë një automjet

zëvendësues në situatat kur objekti i qirasë është jashtë funksionit për shkaqe objektive, për një numër të pakufizuar ditësh.

8.3 Me kontraktimin e shërbimit, Qiramarrësi fiton mundësinë e përdorimit të automjetit zëvendësues sipas paketës së përzgjedhur, ndërkohë që mospërdorimi i këtij shërbimi nuk e çliron Qiramarrësin nga detyrimet për të paguar tarifën mujore të rënë dakord dhe as nuk i lë Qiramarrësit mundësinë/të drejtën për të kërkuar rimbursim të cilësdo prej shumave mujore që paguhet lidhur me këtë.

8.4 Palët në Kontratë janë dakord që numri eventual i ditëve të papërdorura të shërbimit të automjetit zëvendësues, mund të transferohen në automjete që janë objekt i Kontratave të tjera të Qirasë të lidhura ndërmjet PL dhe Qiramarrësi, përveç rasteve kur kjo dispozitë përjashtohet me marrëveshje të palëve kontraktuese.

8.5 Për nevojën e përdorimit të automjetit zëvendësues, Qiramarrësi, do të informojë me shkrim (me e-mail) PL që merr përsipër, brenda 48 orëve, duke llogaritur nga momenti i marrjes së kërkesës, nëpërmjet një partneri të autorizuar për të ofruar këtë shërbim ose nga flota e vet, t'i sigurojë Qiramarrësit një automjet zëvendësues.

8.6 Me nënshkrimin e këtyre Kushteve, Qiramarrësi konfirmon që njëj dhe kupton çfarë parashikohet më lart. Për këto arsye, me rastin e dorëzimit për përdorim të një automjeti zëvendësues Qiramarrësit, nga ana e partnerit të autorizuar të PL ose nga përfaqësuesi i PL, do t'i dorëzohen kushtet e përdorimit të automjetit zëvendësues, ndërsa Qiramarrësi merr përsipër këto kushte me nënshkrimin e formularit të dorëzimit. Qiramarrësi merr përsipër që gjatë periudhës së përdorimit të mjetit zëvendësues, do të veprojë në përputhje me kushtet e përdorimit të automjetit zëvendësues. Qiramarrësi detyrohet që për kohën e përdorimit të automjetit zëvendësues, do të veprojë në përputhje me kushtet e përdorimit të automjetit zëvendësues si dhe që në tërësi do të respektojë procedurat e dhëna në kushtet e përdorimit.

8.7 Qiramarrësi angazhohet që me automjetin zëvendësues, për të gjithë kohën e përdorimit të tij, do të silltet me Vëmendjen e një përdoruesi të mirë. Në përputhje me sa është rënë dakord, Qiramarrësi merr përsipër të kompensojë të gjithë dëmet që mund t'i ndodhin automjetit zëvendësues gjatë përdorimit të tij, pavarësisht nëse dëmi është shkaktuar nga neglizhenca e qiramarrësit ose nga ndonjë pale e tretë. Shumat e mundshme të përcaktuara të dëmeve në automjetin zëvendësues do të shlyhen menjëherë nga Qiramarrësi, i cili duke nënshkruar këto Kushte bie dakord shprehimisht që për të shlyer detyrimet që rrjedhin mbi këtë bazë, mund të përdoren mjetet e sigurisë të ofruara në bazë të Kontratës së Qirasë. I njëjti rregull do të zbatohet nëse, pas kthimit të mjetit zëvendësues, vjen për pagesë një faturë parkimi dhe/ ose ndonjë gjobë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor, dhe Qiramarrësi bie dakord që PL, të mund t'ja japë informacionin për identitetin e tij, si përdorues i mjetit zëvendësues, partnerit të autorizuar që është pronar i mjetit zëvendësues apo autoriteteve qeveritare. Qiramarrësi është i detyruar të kthejë automjetin me sasinë e karburantit në rezervuar, me të cilin është marrë automjeti, dhe nëse Qiramarrësi nuk vepron në këtë mënyrë, ai është i detyruar të kompensojë shpenzimet e furnizimit me karburant.

8.8 Në Kontratën e Qirasë, me të cilën është rënë dakord për ofrimin e shërbimit shtesë të përdorimit të automjetit zëvendësues, palët do të zgjedhin një nga tre klasat e automjeteve zëvendësuese që do të përdoren nga Qiramarrësi sipas nevojës:

Klasa 1- VW Polo, Seat Ibiza, Skoda Fabia, VW Caddy, VW UP dhe automjete të tjera të së njëjtës klasë, ose të një klase më të ulët
Klasa 2: VW Golf, Seat Leon, Skoda Octavia, Audi A3 dhe automjete të tjera të së njëjtës klasë, ose të një klase më të ulët
Klasa 3: VW Passat, Audi A4, Skoda Superb, VW Crafter dhe automjete të tjera të së njëjtës klasë, ose të një klase më të ulët.

8.9 Palët nënshkruajnë Kontratën e Qirasë, dhe bien dakord që

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

ndryshimi i klasës së kontraktuar të automjeteve zëvendësuese, ose ndryshimi i opsionit të kontraktuar të përdorimit të një automjeti zëvendësues nuk është i mundur gjatë kohëzgjatjes së Kontratës nëpërmjet së cilës u dakordësua ofrimi i shërbimeve shtesë.

9. SHËRBIMI I MARRJES DHE DORËZIMIT TË AUTOMJETIT

9.1 Me ane të këtij shërbimi PL siguron marrjen dhe dërgimin e automjetit, kur është e nevojshme, për të kryer ndërrimin e gomave, servisit të rregullt, dhe kontrollit teknik të automjetit. PL e merr përsipër të kryejë këtë shërbim nëse kjo është evidentuar shprehimisht dhe e dakordësuar më Kontratën e Qirasë, në situatat dhe në Vëllimin e përcaktuar në Kontratë, në përputhje me këto Kushte.

9.2 Për nevojat e shfrytëzimit të shërbimit të mësipërm, Qiramarrësi e ka për detyrë të njoftojë PL të paktën 48 orë përpara.

9.3 Si ngjarje, në përputhje me dispozitat e Kontratës së Qirasë, konsiderohet të jetë një marrje dhe dorëzim i një automjeti që është objekt i Kontratës së Qirasë për qëllime të ndërrimit të gomave të automjetit, servisit të rregullt dhe kontrollit të rregullt teknik. Fusha e shërbimeve të dorëzimit dhe marrjes kontraktohet për një numër fiks ngjarjesh dhe gjatë vlefshmërisë së Kontratës, numri i ngjarjeve nuk mund të ndryshohet.

Numri i kontraktuar i ngjarjeve i referohet ekskluzivisht automjetit që është objekt i Kontratës me të cilën është lidhur ky shërbim, dhe nuk është e mundur që të transferohet tek ndonjë automjet tjetër.

9.4 Duke kontraktuar shërbimin e marrjes dhe dorëzimit të automjetit, Qiramarrësi fiton mundësinë e përdorimit të tij, ndërsa mospërdorimi i këtij shërbimi nuk e çliron Qiramarrësin nga detyrimi për të paguar tarifën mujore të rënë dakord mbi këtë bazë dhe as nuk i lë Qiramarrësit të drejtën për të kërkuar një rimbursim të çfarëdo shume mujore të paguar mbi këtë bazë.

10. SHËRBIMI I ASISTENCËS SË FLOTËS

10.1 Shërbimi shtesë i asistencës së flotës nënkupton tërheqjen / rimorkimin në servisim më të afërt të autorizuar të shërbimit. PL është i detyruar ta ofrojë këtë shërbim nëse është rënë dakord shprehimisht në Kontratën e Qirasë, në situatat dhe masën e përcaktuar nga Kontrata e Qirasë, dhe në përputhje me këto Kushte.

11. SHËRBIMI I MBIKËQYRJES GPS TË AUTOMJETIT

11.1 Shërbimi shtesë i mbikëqyrjes GPS të automjetit, nënkupton vendosjen e paisjes GPS/GPRS dhe instalimin e tij në system, shërbimin e ofrimit të mbështetjes teknike ne lidhje me ndjekjen e automjetit me ndihmën e paisjes GPS/GPRS, akses i vazhdueshëm në gjurmimin e automjeteve përmes qendrës së kontrollit të Partnerit të PL për të ofruar këtë shërbim, dhe PL është i detyruar të ofrojë këtë shërbim nëse është kontraktuar shprehimisht në Kontratën e Qirasë, në situatat dhe në Vëllimin e përcaktuar nga Kontrata e Qirasë dhe në përputhje me këto Kushte.

11.2 Të gjitha paisjet për mbikëqyrjen GPS të automjetit, do të instalohen të reja në objektin e qirasë, me garancinë e lëshuar nga prodhuesi për funksionimin e rregullt, me vlefshmëri sa afati i kohëzgjatjes së Kontratës së Qirasë.

11.3 Shpenzimet për servisimin e rregullt të paisjeve GPS/GPRS në afatin e garancisë e kryen Partneri i PL për ofrimin e këtij shërbimi, që i mbulon vetë pa kompensim, me përjashtim të rastit kur mosfunksionimi i paisjes GPS/ GPRS ndodh si rezultat i përpjekjeve për

riparimin e paisjes GPS nga persona të paautorizuar, heqjes së etiketave të garancisë dhe shenjave të tjera nga pajisja GPS, shfaqja e dëmtimeve fizikë të shkaktuara nga përdorimi i forcës fizike (në rast aksidenti rrugor, duke manipuluar objekte të ndryshme pranë pajisjes GPS/ GPRS etj.), si dhe në rast të një problemi me burimin e energjisë të paisjes GPS/GPRS e shkaktuar nga një bateri ose burim alternative i dëmtuar.

11.4 Shpenzimet shtesë të kryera për mirëmbajtjen e paisjes për mbikëqyrjen GPS të automjetit, që nuk janë objekt i Kontratës dhe përfaqësojnë detyrimin ekskluziv të Qiramarrësit, pa të drejtë rimbursimi të shpenzimeve të bëra nga PL.

11.5 Gjatë përdorimit të paisjes për monitorimin e automjeteve me anë të GPS, Qiramarrësi merr përsipër të veprojë në të gjitha aspektet në përputhje me termat dhe kushtet e prodhuesit, të cilat dorëzohen në ditën e lidhjes së Kontratës, nëpërmjet së cilën kontraktohet edhe ofrimi i këtij shërbimi shtesë.

11.6 Paisja për mbikëqyrjen GPS të automjeteve, nuk mund të montohet në objektin e qirasë në mënyrë të tillë që të dëmtojë ose zvogëlojë vlerën funksionale dhe/ ose estetike të objektit të qirasë dhe duhet të vendoset në atë mënyrë që të mos ndikojë në në humbjen e garancisë së objektit të qirasë, lëshuar nga prodhuesi i objektit të qirasë.

12. TARIFA PËR LËSHIMIN E DOKUMENTACIONIT OSE OFRIMIN E SHËRBIMEVE PËR NJË HERË

12.1 Ky shërbim shtesë nënkupton që Qiradhënësi do të përballojë shpenzimet e lëshimit të dokumentacionit ose shpenzime të tjera sipas kërkesës, dhe PL është i detyruar ta ofrojë këtë shërbim nëse është kontraktuar shprehimisht si shërbim i mundshëm me Kontratën e Qirasë, ndërkohë që Qiramarrësi mbi këtë bazë merr përsipër të paguajë shpenzimet e parafaturuara përmes një fature shtesë të lëshuar në faturën e parë pasardhëse të qirasë pas shërbimit të porositur nga Qiramarrësi dhe të rritur me një tarifë të përshatshme, nëse palët bien dakord për kërkesën e marrë.

13. TARIFA E ADMINISTRIMIT

13.1 Tarifa përfshin shërbimin e ofruar për administrimin në lidhje me objektin e qirasë, konsulencën dhe mbështetjen logjistike dhe menaxhimin e ngjarjeve të padëshiruara (këshilla në momentin e shfaqjes së një ngjarjeje të pafavorshme/ dëmsjellëse, likuidimi/ pagesa/arkëtimi i dëmeve, përzgjedhja e shërbimit për riparimin), inspektimi i automjeteve aktive dhënë me qira sipas zgjedhjes së Qiramarrësit.

PJESA III

14. PAGESAT

14.1 Të gjitha shumat e tarifave për shërbime shtesë janë të shprehura në euro (EUR). Nëse palët bien dakord për një klauzolë valutore, llogaritja e tarifave për shërbimet shtesë kryhet me kursin e këmbimit të rënë dakord, i cili përcaktohet në Kontratën e Qirasë, në ditën e llogaritjes.

14.2 Kur është dakordësuar ofrimi i shërbimeve shtesë të përlllogaritura, Qiramarrësi merr përsipër që t'i paguajë Qiradhënësit detyrimin mujor gjithsej, sipas Kontratës, nëpërmjet të cilës është rënë dakord ofrimi i shërbimeve shtesë, pra shumën e përlllogaritur në përputhje me rakordimet e kryera në periudhën kur ato u kryen. Shuma mujore e detyrimit sipas Kontratës përbëhet nga tarifa mujore e menaxhimit të shërbimit, shumat mujore e llogaritur bazuar në të gjitha shërbimet shtesë të kontraktuara

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania
Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

(mirëmbajtjen e automjeteve dhe shërbimet shtesë të kontraktuara) dhe të gjitha taksat e përcaktuara me ligj.

15 RREGULLIM I TARIFAVE PËR SHËRBIMET SHITESË TË NDRYSHUESHME

15.1 Nëse me Kontratën e Qirasë është dakorduar ofrimi i shërbimeve shtesë të ndryshueshme, PL do të kryejë një monitorim të rregullt duke krahasuar tarifat mujore që janë paguar dhe kostot aktuale të ofrimit të shërbimeve shtesë, një herë në vit, më 31 Dhjetor, por jo para skadimit të një periudhe 18 mujore nga lidhja e Kontratës së Qirasë me të cilën janë kontraktuar shërbimet shtesë. Nëse, gjatë monitorimeve periodike, PL përcakton që kostot e ofrimit të shërbimeve shtesë devijojnë nga shuma e paguar e tarifave, PL do të bëjë një ndryshim në shumën e tarifave të shërbimit. Krahas rakordimeve të rregullta, PL është i autorizuar të rregullojë shumat mujore të dakorduara të faturimit edhe në rast se gjatë zbatimit të Kontratës konstatohet një mospërputhje e konsiderueshme ndërmjet kostove të llogaritura dhe atyre të bëra realisht, e cila ka ndodhur për shkak të mënyrës të shfrytëzimit të objektit të dhënë me qira dhe kostot e shërbimit të bëra mbi këtë bazë.

15.2 Gjatë rakordimit, nuk kërkohet pëlqimi i Qiramarrësit, por PL do ta informojë Qiramarrësin me shkrim për ndryshimet, me të cilat Qiramarrësi pajtohet plotësisht me nënshkrimin e tij në këto Kushte.

15.3 Krahas dispozitave të përgjithshme për ndryshimet, që janë parashikuar me Nenin 15.1 të këtyre Kushteve, përcaktohen gjithashtu dispozita të veçanta me të cilat bëhet ndryshimi i tarifave për shërbimet shtesë si më poshtë:

- Rregullimi i tarifës së mirëmbajtjes së gomave në automjet - Palët kontraktuese bien dakord që duke harmonizuar shumat mujore fikse të përlogaritura për mirëmbajtjen e gomave në automjet, do të përfshihen edhe shërbimet shoqëruese të ndërrimit të gomave dhe magazinimit të gomave.
- Rregullimi për tarifën e regjistrimit - rakordimi i shumave mujore të përlogaritura për regjistrimin e objekteve të qirasë kryhet në bazë vjetore në rastin e rinovimit të regjistrimit, në përputhje me të gjitha shpenzimet e bëra dhe tarifat administrative të paguara.
- Rregullimi për rimbursimin e shpenzimeve të policës së sigurimit të autopërgjegjësive - rregullimi i shumave mujore të llogaritura të rimbursimit të kostove të policës së sigurimit kasko kryhet në baza vjetore, gjatë çdo rinovimi të regjistrimit në përputhje me rregulloret ligjore që përcaktojnë normat e primit të sigurimit të detyrueshëm, detyrimet tatimore të vendosura mbi këtë shumë qëarkullimi të rezultuar dhe zbritjet/ritjet e shumës së primit të sigurimit në përputhje me sistemin bonus/malus.
- Rregullimi i kompensimit të kostos së policës kasko - rakordimi i shumave mujore të kompensimit të policës kasko kryhet në baza vjetore, në çdo rinovim të policës, në përputhje me detyrimet tatimore të vendosura mbi këtë qarkullim dhe zbritjet/ritjet në shumën e primit në përputhje me sistemin bonus/malus.

16. VONESA

16.1 Palët në Kontratë deklaronë se përbushja e detyrimeve në afat përfaqëson element të rëndësishëm të Kontratës së Qirasë, me të cilën është dakordësuar edhe ofrimi i shërbimeve shtesë.

16.2 Në rast vonëse të pagesave, të çfarëdo shume sipas Kontratës, Qiramarrësi detyrohet që ti paguajë PL, kamatvonesat e përlogaritura për çdo ditë vonëse, në përputhje me rregullat. Në rast të pagesës me vonëse nga Qiramarrësi të detyrimeve që rrjedhin dhe në bazë të shërbimeve shtesë, do të zbatohen dispozitat për

paralajmërimin, të cituara në Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Qirasë të cilat janë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë, me të cilën Qiramarrësi shprehimisht pajtohet me nënshkrimin e tyre.

16.3 Nëse Qiramarrësi nuk shlyen detyrimet e maturuara dhe të papaguara sipas Kontratës, edhe pas marrjes së paralajmërimit të tretë, PL, është i autorizuar të ndërpresë në mënyrë të njëanshme Kontratën e Qirasë, dhe të bëjë një llogaritje në përputhje me Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme të Kontratës së Qirasë, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të Kontratës së Qirasë dhe këtyre Kushteve, me nisjen e të gjitha pasojave kontraktuale të zgjidhjes së parakohshme për faj të Qiramarrësit. Gjatë llogaritjes, detyrimet totale të Qiramarrësit do të përcaktohen si në bazë të dispozitave të Nenit 20 të këtyre Kushteve ashtu edhe në bazë të dispozitave të Afateve dhe Kushteve të Përgjithshme të Punës, të cilat përbëjnë një pjesë përbërëse integrale të Kontratës e së Qirasë.

16.4 Në rast se të gjitha detyrimet e maturuara dhe të papaguara të Qiramarrësit konform Kontratës nëpërmjet së cilës shërbimet shtesë të dakordësuar kalojnë shumën prej 500,00 EUR, PL mund të refuzojë të përbushë detyrimet e tij sipas Kontratës derisa Qiramarrësi të paguajë të gjitha detyrimet e tij të maturuara.

17. PËRDORIMI I AUTOMJETIT

17.1 Qiramarrësi është i detyruar të kujdeset me Vëmendjen e një përdoruesi të mire, për automjetin e dhënë me qira, duke respektuar plotësisht udhëzimet e prodhuesit për mirëmbajtjen dhe funksionimin, si dhe kushtet nga garancia e prodhuesit për objektin e qirasë.

17.2 Qiramarrësi gjithashtu merr përsipër të përdorë automjetin në përputhje me rregulloret lidhur me sigurinë e qarkullimit rrugor dhe në përputhje me mënyrën optimale të shfrytëzimit të mjetit. PL do të ofrojë shërbimet e kontraktuara në atë mënyrë që të sigurojë përdorimin e automjetit në përputhje me standartet që parashikon legjislacioni. Nëse Qiramarrësi ka nevojë të veçantë për të përdorur automjetin në mënyrë që të devijojë nga standardet e përcaktuara, ai është i detyruar të informojë PL për këtë, sipas Kontratës, në të cilën kontraktohen shërbime shtesë.

17.3 Nëse ekziston dyshimi që Qiramarrësi e përdor automjetin në mënyrë të pandërgjegjshme, nga pakujdesia, ose përdorimi nuk përputhet me udhëzimet për mirëmbajtjen dhe funksionim si dhe me kushtet e garancisë, Qiramarrësi do të lejojë një ekspert të autorizuar të inspektojë automjetin me kërkesë të PL. Nëse dyshimi konfirmohet pas kontrollit të automjetit, PL ka të drejtë të kërkojë kompensim për shpenzimet e kontrollit nga Qiramarrësi, plus të gjitha taksat e përcaktuara nën legjislacion. Nëse Qiramarrësi nuk lejon një ekspert të inspektojë automjetin brenda tre ditëve nga marrja e njoftimit nga PL, do të konsiderohet se Qiramarrësi po e trajton automjetin në mënyrë të pandërgjegjshme, domethënë nuk respekton udhëzimet e mirëmbajtjes dhe përdorimit si dhe kushtet e garancisë.

17.4 Nëse vërtetohet dyshimi që Qiramarrësi po e përdor automjetin në mënyrë të pandërgjegjshme, nga pakujdesia ose përdorimi nuk përputhet me udhëzimet për mirëmbajtjen dhe funksionim si dhe me kushtet e garancisë, dhe nëse Qiramarrësi brenda një afati 3-ditor nga marrja e një njoftimi të tillë prej Qiradhënësit, nuk lejon një ekspert të autorizuar të inspektojë automjetin objekt të qirasë, PL është i autorizuar që Kontratën e Qirasë me të cilën janë kontraktuar shërbimet shtesë, ta zgjidhë në mënyrë të njëanshme për fajin e Qiramarrësit dhe të kryejë përlogaritjen në përputhje me Afatet dhe Kushtet e Përgjithshme, që janë pjesë përbërëse e Kontratës së Qirasë dhe e këtyre Kushteve.

18. DETYRIMI I RAPORTIMIT

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

18.1 Të dhënat e sakta dhe të plota (adresa, targat e automjetit dhe të dhëna të ngjashme) dhe veprimet e kryera në lidhje me ato të dhëna (dorëzimi i shkresave etj.) konsiderohen ligjërisht të vlefshme dhe detyruese për të dyja palët kontraktuese. Në këtë drejtim, Qiramarrësi është i detyruar të njoftojë me shkrim PL pa vonesë për çdo ndryshim adresa/selia e biznesit, targat e automjetit dhe çdo ndryshim tjetër që është i rëndësishëm për ekzekutimin e Kontratës dhe këtyre Kushteve, të cilat janë pjesë përbërëse të saj.

19. FILLIMI DHE MBARIMI I OFRIMIT TË SHËRBIMEVE SHITESË

19.1 Si ditë fillimi konsiderohet data në të cilën nënshkruhet Kontrata.

19.2 Ofrimi i shërbimeve shtesë normalisht përfundon në fund të afatit të Kontrata së Qirasë.

19.3 Kontrata e Qirasë, në të cilën janë kontraktuar edhe shërbimet e mirëmbajtjes, përfundon në rast të përfundimit të Kontratës së Qirasë për arsyet e përcaktuara në Kushtet e Përgjithshme të Qirasë të PL, si dhe në rastet kur shkelen dispozitat e kontraktuara të përcaktuara në Kontratën e Qirasë, e veçanërisht: -në rast të vonesës në likuidimin e pagesave të shërbimeve të kontraktuara; -në rast të përdorimit të automjetit në atë mënyrë që nuk është në përputhje me Nenin 17 të këtyre Kushteve; -në rastin e mospërbushjes së detyrimeve të zëvendësimit të mjeteve të sigurimit.

19.4 Në rast vjedhjeje ose kur shkaktohet dëmtim total i automjetit, i cili është objekt i ofrimit të shërbimeve shtesë nga Kontrata, dhe konstatimit nga ana e siguruesit, deri në përfundim të afatit të vlefshmërisë së Kontratës, në datën e maturimit të pagesës mujore pasardhëse sipas marrëveshjes, duke përllogaritur nga data e raportimit të vjedhjes / dëmtimit tek PL.

Në rast se ofrimi i shërbimeve shtesë të përllogaritura është rënë dakord në Kontratën e Qirasë, PL do të bëjë një përllogaritje referuar dispozitës 20.2 të këtyre Kushteve.

19.5 Në rast zgjidhjeje të parakohshme të Kontratës së Qirasë, pavarësisht nga arsyeja e zgjidhjes, ashtu si edhe në rastin e përfundimit të afatit të Kontratës së Qirasë, Qiramarrësi ka detyrim t'i kthejë menjëherë PL kartën e përdoruesit.

20. DETYRIMET E QIRAMARRËSIT NË RASTIN E ZGJIDHJES SË PARAKOZHSHME /PËRFUNDIMIT TË AFATIT TË KONTRATËS SË QIRASË

20.1 Në përfundim të afatit të Kontratës së Qirasë, si dhe në rastin e zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Qirasë, në të cilën është rënë dakord për ofrimin e shërbimeve shtesë, Qiradhënësi do të rakordojë të gjitha detyrimet e maturuara dhe të përllogaritura të Qiramarrësit, bazuar në shërbimet shtesë. Në rast se me këtë rakordim Vërtetohet ekzistenca e detyrimeve të maturuara por të papaguara, nga dhe mbi bazën e shërbimeve shtesë, PL është i autorizuar të arkëtojë këto shuma, si dhe të shumës së borxhit referuar Kontratës së Qirasë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e sigurimit të dhënë mbi bazën e Kontratës së Qirasë, përfshirë edhe shumën e garancisë së marrë, gjë për të cilën Qiramarrësi shpreh dakordësinë e plotë me nënshkrimin e këtyre Kushteve. Detyrimi i Qiramarrësit në bazë të përllogaritjes së shërbimeve shtesë përcaktohet në mënyrë të pavarur nga detyrimi në bazë të Qirasë së automjetit.

PËRLLOGARITJA BAZUAR NË SHËRBIMET SHITESË NË RASTIN E ZGJIDHJES SË PARAKOZHSHME / PËRFUNDIMIT TË AFATIT TË KONTRATËS SË QIRASË

Përfundimi i afatit të Kontratës së Qirasë.

20.2 Në përfundim të kohëzgjatjes së marrëveshjes, Qiramarrësi do të bëjë rakordimin midis të gjithë detyrimeve mujore të paguara/maturuara dhe shpenzimeve faktike të ndodhura bazuar në shërbimet shtesë (në rakordim nuk paguara ndaj Qiradhënësit, mbi bazën e shërbimeve shtesë të përllogaritura si dhe diferencën ndërmjet të gjitha shumave përfshihet shpërblimi mujor për administrimin e shërbimeve) konkretisht:

- diferenca e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për mirëmbajtjen e automjetit,
- diferenca e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për mirëmbajtjen e gomave të automjetit,
- diferenca e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për regjistrimin e automjetit,
- diferenca e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për sigurimin e detyrueshëm për autopërgjegjësitë TPL,
- diferenca e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për sigurimin kasko të automjetit.

20.3 Në rast se shumat mujore të përllogaritura tejkalojnë shpenzimet reale të kryera në bazë të shërbimeve shtesë, dhe kur Qiramarrësi ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj PL, shuma e konstatuar e shpenzimeve të mbipaguara do t'i kthehet Qiramarrësit, domethënë do të përdoret për të shlyer të gjitha detyrimet e evidentuara të Qiramarrësit në bazë të qiradhënies së automjetit, gjë me të cilën Qiramarrësi pajtohet shprehimisht me nënshkrimin e tij në këto Kushte.

20.4 Në rast se nga rakordimi (përllogaritja) Vërtetohet që shumat mujore (në të cilat nuk përfshihen shpenzimet për administrimin e shërbimeve) janë më të vogla se shpenzimet reale të kryera nga PL, për Qiramarrësin do të përpilohet fatura shtesë, ndërkohë që PL, është i autorizuar të kryejë arkëtimin e kësaj shume si dhe të shumës së detyrimit, në bazë të Kontratës së Qirasë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e sigurimit të dhëna referuar kësaj Kontrate, përfshirë edhe shumën e garancisë së marrë bazuar në Kontratën e Qirasë, gjë me të cilën Qiramarrësi pajtohet shprehimisht me nënshkrimin e tij në këto Kushte.

Zgjidhja e parakohshme e Kontratës për faj të Qiramarrësit

20.5 Në rastin e zgjidhjes së Kontratës për arsyet e përcaktuara në Nenin 19.3, si dhe në çdo rast tjetër të zgjidhjes së parakohshme të Kontratës për fajin ose me kërkesën e Qiramarrësit, Qiramarrësi është i detyruar t'i paguajë PL, në një shumë të vetme, në bazë të shërbimeve shtesë, të gjitha detyrimet e maturuara dhe të papaguara të shkaktuara deri në datën e zgjidhjes (kërkesat e bazuara në mirëmbajtjen e automjetit dhe shërbime të tjera shtesë të kontraktuara), shtuar me:

- diferenca eventuale e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për mirëmbajtjen e automjetit,
- diferenca eventuale e konstatuar ndërmjet shpenzimeve të përllogaritura dhe shpenzimeve reale të bëra për mirëmbajtjen e gomave të automjetit,
- tërësisht pjesa e mbetur e shumave mujore të qirasë, bazuar në regjistrimin për vitin, marrëveshje për të cilën ndodhi zgjidhja/ ndërprerja,
- tërësisht pjesa e mbetur e shumave të siguracionit të detyrueshëm, për vitin, marrëveshje për të cilën ndodhi zgjidhja/ ndërprerja,
- tërësisht pjesa e mbetur e shumave të siguracionit kasko,

PORSCHE LEASING SHPK

Autostrada Tiranë-Durrës, Km.7 | Rruga Monun | Kashar | Tiranë | Albania

Phone: + 355 (04) 450 08 28 | Fax: + 355 (04) 450 08 29 | www.porscheleasing.al

NIPT: L31623008N

Nr. llogarie: 0003740323 (EUR), IBAN: AL6320211075000000003740323, Raiffeisen Bank

Porsche Leasing Sh.p.k.

pakësuar me shumën e rimbursuar, si premio e papërdorur nga ana e siguruesit, kthyer PL,

- diferenca ndërmjet shumave mujore të përlogaritura mbi bazën e përdorimit të automjetit zëvendësues dhe shpenzimeve reale të ndodhura me përdorimin e automjetit zëvendësues,
- tërësisht pjesa e mbetur e shumave të kontraktuara mbi bazën e shërbimit të GPS,
- diferenca ndërmjet kostove mujore të përlogaritura mbi bazën e shërbimit të dëgimit dhe marrjes së automjetit dhe shpenzimeve reale të ndodhura me përdorimin e këtij shërbimi.

20.6 Në rast se shumat mujore të përlogaritura tejkalojnë shpenzimet reale të kryera në bazë të shërbimeve shtesë, dhe kur Qiramarrësi ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj PL, shuma e konstatuar e shpenzimeve të mbipaguara do t'i kthehet Qiramarrësit, domethënë do të përdoret për të shlyer të gjitha detyrimet e evidentuara të Qiramarrësit në bazë të Kontratës së Qirasë, gjë me të cilën Qiramarrësi pajtohet shprehimisht me nënshkrimin e tij në këto Kushte.

Në rast se nga rakordimi (përlogaritja) Vërtetohet që shumat mujore

21. MARRËVESHJE TË VEÇANTA

21.1 Marrëveshjet e veçanta janë të vlefshme dhe detyruese për palët nënshkruese, vetëm nëse janë bërë në formë shkresore, janë nënshkruar nga ana e personave të autorizuar, dhe të vërtetuara me vulat e palëve kontraktuese.

(në të cilat nuk përfshihen shpenzimet për administrimin e shërbimeve) janë më të vogla se shpenzimet reale të kryera nga PL, për Qiramarrësin do të përpilohet fatura shtesë, ndërkohë që PL, është i autorizuar të kryejë arkëtimin e kësaj shume si dhe të shumës së detyrimit, në bazë të Kontratës së Qirasë, të shfrytëzojë të gjitha mjetet e sigurimit të dhëna referuar kësaj Kontrate, përfshirë edhe shumën e garancisë së marrë bazuar në Kontratën e Qirasë, gjë me të cilën Qiramarrësi pajtohet shprehimisht me nënshkrimin e tij në këto Kushte.

20.7 Në përlogaritjen/ rakordimin mbi këtë bazë, nuk përfshihet tarifa mujore e menaxhimit të shërbimeve. Elementet e përlogaritjes janë marrë veçanërisht parasysht nga Qiramarrësi gjatë lidhjes së Kontratës, për këto arsye ai heq dorë nga kundërshtimet për ndryshimin e rrethanave, veçanërisht në lidhje me shumën dhe mënyrën e përcaktimit të totalit të detyrimeve në rast të zgjidhjes/ndërprerjes së parakohshme të Kontratës.

20.8 Detyrimet e Qiramarrësit në bazë të përlogaritjes maturohen në datën e rakordimit dhe PL është i autorizuar të përdorë të gjitha fondet e sigurimit të marra sipas Kontratës së Qirasë për të mbledhur shumën e përcaktuar mbi atë bazë, gjë me të cilin Qiramarrësi pajtohet shprehimisht me nënshkrimin e tij të këtyre Kushteve.

PORSCHE LEASING Sh.p.k.

GARANTUESI
(nëse është i aplikueshëm)

QIRAMARRËSI